

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7645 E shtunë 8 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ANDI BUSHATI

Lulzim Basha ka hedhur në treg një tjetër propozim qesharak, atë për të bërë vetingun e politikanëve të lidhur me krimin. Për këtë, ai ka thënë se do ...
Vijon në faqen 20

Blofi fëmijëror i vetingut të politikanëve



Opinion

Ditës

Nga HOWARD KURTZ

Presidenti Trump dhe aleatët e tij po zhvillojnë një sulm publik ndaj librit më të ri të Bob Woodwardit, por le ta themi qartë, ky i fundit nuk është Omarosa ...
Vijon në faqen 21

Trumpi s' mund ta neutralizojë lehtë Woodwardin



Memaliaj/ Arrestohen babë e bir

Ekzekutimi i Alket Muhos, dy kushërinjtë e viktimës në pranga

Policia: Dyshohet për motive pronësie.
Gjolek Muho: Dua drejtësi

TEPELENË - Një ditë pas ekzekutimit me plumb në kokë të 43-vjeçarit Alket Muho në fshatin Rabie në Memaliaj, policia ka bërë të mundur identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës mbrëmë bënë me dije se pas hetimeve intensive u zbuluan autorët ...
Në faqen 8

NDERTIMET PA LEJE/ LISTA ME PERFITUESIT NE TE GJITHE SHQIPERINE

QEVERIA: EMRAT, TAPI PER TRUALLIN PER 300 PRONARE

Llogariten sipërfaqet takuese për pronarët e objekteve të legalizuara, poseduesit marrin certifikatën e pronësisë mbi tokën ku kanë ndërtuar



(Në foto) Ndërtime pa leje

ASAMBLEJA E PS

Ndryshime në kryesinë e sekretarit të PS, emrat e rinj që ikin e vijne
Në faqen 2

LISTA E RE

Të përndjekurit, 100 personat që përfitojnë nga dëmshpërblimi
Në faqen 7

ZBARDHET DRAFTI

PD: Ja ligji ynë për veting në politikë. Rama: Gati ta nisim nga familjet tona
Në faqen 3

STRUKTURA

Zbardhen planet mësimore për arsimin parauniversitar
Në faqen 10-11

MUNDET IZRAELI



Taulant Xhaka dhe Strakosha i japin fitoren e parë Shqipërisë
Në faqen 22



Adi Krasta në "News 24", të rejtat më të fundit nga bota e medias televizive

Klaudia Kalia: Më ofruan para të braktis modelingun

Jona Spahiu publikon fotot e dasmës. Stresi shfaqet i dashuruar

PAMELA ALIAJ

Jeni sërish pjesëmarrëse e "Miss Grand International 2018", kësaj radhe në Myanmar. Si ju përzgjedhën dhe si ndiheni që do përfaqësoni Shqipërinë? Siç e kam shprehur në postimin



që kam publikuar, është "Miss Grand International" në Tailandë, duke qenë më e pëlqyera 'online' vitin e shkuar; vendosën të më përzgjedhnin së bashku me producentin shqiptar, Aleks Tanushi, si konkurrenten ...
Suplement

ASAMBLEJA E PS-së VENDIMET

Ikën Ulqini, rikthehet Petro Koçi, Fino nënkryetar i Asamblesë

Ndryshime në kryesinë e sekretarin e PS, emrat e rinj që ikin e vijnë

Felaj dhe Manja votohen si anëtarë të kryesisë

Darina Tanushi

Partia Socialiste ka bërë dje, ndryshime në sekretarin e saj, duke shtuar emra të rinj në forumet e saj të larta. Anëtarët e Asamblesë Kombëtare kanë votuar në postin e nënkryetarit të këtij forumi Bashkim Finon. Organizimi i partisë i është besuar një deputeti të ri, por një socialisti të hershëm Arben Pëllumbit. Ndërkohë Ulsi Manja dhe Ermonela Felaj do të hyjnë si anëtarë të kryesisë së PS-së. Në forumet e larta të PS-së kanë hyrë emra të rinj, por janë larguar edhe të vjetër. Kështu Musa Ulqini nuk do të mbajë më postin e sekretarit për burimet njerëzore dhe koalicionet. Ky pozicion i është besuar zv. kryeministres Senida Mesi, ndërkohë që zv. ministrja e Brendshme Romina Kuko do të jetë nënkryetare. Elisa Spiropali do të mbajë pozicionin e sekretares për Bashkëqeverisjen dhe Aleancat së bashku me zv. ministrin e Mbrojtjes Petro Koçi, një socialist i vjetër dhe një prej sekretarëve organizativë më të suksesshëm që ka pasur Partia Socialiste ndër vite. Alfred Peza rikthehet në sekretariatit e PS-së në pozicionin e sekretarit për marrëdhëniet me median. Kryetari i PS-së Edi Rama i ka besuar sërish Blerina Gjylametit Koordinatorin Elektorale, ndërsa Ilir Beqaj do të jetë sekretari digital, duke pasur kështu përgjegjësinë e regjistrat të anëtarësisë. Stefan Çipa, pas emërimit në detyrën e Drejtorit të Burgjeve nuk do të jetë më sekretar për emigracionin. Laert Duraj do të zërë këtë pozicion, ndihmuar edhe nga zv. ministrja e Jashtme Artemis Daralo. Sekretar për çështjet zgjedhore do të jetë Bledi Çuçi, i cili do të ketë si nënkryetarë zv. ministrin e Brendshëm, Julian Hodaj dhe një prej avokatëve të njohur të PS-së dhe përfaqësues në KQZ, Eridan Sallianjin. Sekretare për marrëdhëniet ndërkombëtare do të vijojë të jetë Teuta Vodo, e cila u propozua nga kryeministri Rama si një njohëse shumë e mirë e Brukselës dhe lidhjeve që ka në Bashkimin Evropian.

RIFORMATIMI I SEKRETARIATIT TË PSSH:

1. Sekretar për Organizimin - Arben Pëllumbi
- * Nën/Sekretar - Shpati Kolgega
2. Sekretar për Koordinimin Elektorale - Blerina Gjylametit
- * Nën/ Sekretar - Elton Semanaj
- * Nën/ Sekretar - Ermira Rusi
3. Sekretare për Burimet Njerëzore - Senida Mesi
- * Nën/sekretare - Romina Kuko
4. Sekretar Digital - Ilir Beqaj
5. Sekretar për Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile dhe Mediat - Alfred Peza.
6. Sekretar për Çështjet Zgjedhore - Bledi Çuçi
- *Nën/Sekretar - Julian Hodaj
- *Nën/Sekretar-Eridan Sallianji
7. Sekretar për Emigracionin - Laert Duraj
- *Nën/Sekretare- Artemisa Daralo
8. Sekretare për Bashkëqeverisjen dhe Aleancat - Elisa Spiropali
- *Nën/Sekretar - Petro Koçi
9. Sekretare për Marrëdhëniet Ndërkombëtare - Teuta Vodo
10. Nënkyetar i Asamblesë Kombëtare - Bashkim Fino
11. Kooptime në Kryesinë e Partisë Socialiste:
 - Ulsi Manja
 - Ermonela Valikaj (Felaj)

Kreu i grupit të PS-së: Do garojmë si fitues në 61 bashki

Zgjedhjet vendore, Balla: koalicion me njerëzit, bashkëpunim me opozitën

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, në fjalën e tij para të pranishmëve në Asamble u shpreh se PS do të garojë si fitues në 61 bashkitë e vendit. "Sot, jemi vetëm 250 ditë larg zgjedhjeve vendore të vitit 2019 dhe për ne, prej sot, fillon sezoni politik, me këtë mbledhje të Asamblesë Kombëtare, i cili përfundon me përfundimin e zgjedhjeve vendore të vitit të ardhshëm, ku ne garojmë si kandidat fitues në të 61 bashkitë e vendit", deklaroi Balla. "Të gjithë e dimë se në Zgjedhjet Vendore 2019, ne kemi vetëm një aleat. Në koalicion me ne do të jenë vetëm qytetarët e thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi dhe përballë kemi përsëri një aleancë politikanësh, që politikën e duan si mjet për interesat e tyre, jo për interesat e Shqipërisë. Ne jemi të vendosur ta kemi vëmendjen vetëm tek njerëzit e thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi. Jemi të përkushtuar për t'u marrë me hallet dhe problemet e njerëzve dhe vëmendja jonë janë vetëm ata", tha kreu i grupit parlamentar të PS-së. "Sigurisht, duke qenë të përgjegjshëm, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me opozitën për reformat e mëdha, që përmirësojnë jetën e njerëzve dhe që bëjnë shitet. Por, nëse opozita do të vazhdojë të zgjedhë baltën si alternativë të vetën, atëherë natyrshëm e gjithë vëmendja jonë do të përqendrohet vetëm tek njerëzit dhe çështjet që kanë të bëjnë vetëm me ta", deklaroi Balla.

LUAN HAJDARAGA

Në nder të ish-ministrit Hajdaraga, me kërkesë të kreut të Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla Asambleja Kombëtare mbajti një minutë heshtje. Ish-ministri socialist Luan Hajdaraga u nda nga jeta vetëm pak kohë më parë.



Asambleja e djeshme e PS-së

Malësia e Madhe, bashkia me performancën më të mirë, 10 bashki dobët

Raporti i Asamblesë, cilët janë kryebashkiakët e pavlerësuar nga PS

Malësia e Madhe rezultoi si bashkia me performancën më të mirë në shërbime për vitin 2017, e pasur nga Bashkia e Tiranës. Ilir Beqja, kryetari i grupit për analizën e punës së çdo bashkie, prezantoi dje, para Asamblesë Kombëtare të PS-së raportin "Mbi performancën e përfaqësuesve të PS-së në qeverisjen vendore". Ai bëri të ditur se kjo analizë bazohet vetëm në të dhënat e raportuara nga vetë bashkitë, mbi investimet e kryera, shpenzimet në arsim, në rrugë bashkiake e rurale, ecuria e mbledhjes së të ardhurave dhe tarifave vendore etj. por, mesa duket kjo do të jetë edhe një nga pasqyrat, ku drejtuesit socialistë do të mbështeten për rikandidimin ose jo të kryetarëve aktualë të bashkive. Raporti është përgatitur nga 4 deputetë dhe ministra të rëndësishëm socialistë dhe konkretisht nga Arben Ahmetaj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni dhe Evis Kushi. Në vend të dytë renditet Bashkia e Tiranës me 3 pikë, ku pikat më të forta të saj janë performanca e administratës në raport me numrin e popullsisë dhe të ardhurat e mbledhura për banorë. Ndërkohë me nga 2 pikë janë renditur



ELISA SPIROPALI

Gjatë punimeve të Asamblesë së Partisë Socialiste, Elisa Spiropali, koordinatoresha Kombëtare për "Bashkëqeverisjen me Qytetarët" tha se platforma e Bashkëqeverisjes ka regjistruar 17 000 ankesa, teksa ka trajtuar dhe zgjidhur 16 000 të tilla.

Bashkia Durrës, Bashkia Librazhd, Bashkia Vlorë, Bashkia Himarë dhe Bashkia Pukë. Ajo që bie në sy në këtë raport vlerësimi është numri

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATEVE PËR KRYETARE BASHKIE

- 1-Të plotësohen kërkesat e përcaktuara në Kushtetut, në kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe në kërkesat e Statutit të PS (Nenet 52-52)
- 2-Të kenë kontribut e angazhim politik dhe të kenë njohuri për programin e politikës dhe PS në nivel kombëtar dhe vendor
- 3-Të kenë arsim të lartë, të zotëronjë aftësi të shpikura profesionale, dhe menaxhuese
- 4-Të gëzojnë reputacion dhe të kenë mbështetje të gjerë në komunitet, të jenë aktiv dhe të angazhuar për të njohur, ndjekur e zgjidhur problemet e komunitetit
- 5-Të kenë njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, aftësi drejtuese, organizuese, e të punës në ekip, të zotërojnë eksperiencë për menaxhimin e burimeve njerëzore e materiale
- 6-Të kenë integritet moral dhe kurajo civile për të luftuar korupsionin, abuzimet me pushtetin dhe shkeljet me ligjin.

i madh i bashkive që kanë marrë 0 pikë. Spikatin mes tyre disa nga bashkitë e mëdha si Fieri, Elbasani dhe Korça.



Asambleja e PS-së, kryeministri kritika krerëve të rretheve: Janë kthyer në shefa kuadri

Rama: Vetingu të nisë nga pronat e gruas time, gati të ulem me Lulin

Përrjashtohet deputeti Gjetani, kreu i PS: Shantazhoi

Darina Tanushi

Kryeministri, njëherësh kryetar i Partisë Socialiste u shpreh mjaft kritik dje, në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të partisë me kryetarët e PS-së në rrethe. Në prag të nisjes së fushatës për zgjedhjet vendore, Rama tha se "partia në territor është larg së qeni Partia Socialiste që duam për sfida që kemi përpara. Është larg së qeni Partia që kryen funksionet e patjetërsueshme dhe të pazvëndësueshme të komunikimit dhe të ndërmjetësimit me ata që na kanë besuar".



Kryeministri Edi Rama

fjala në Asamble për t'i thënë opozitës se është shumë dakord për vetingun e politikaneve. "Unë them që çdo instrument i ri, i mundshëm, që bën transparencë, për mua personalisht të parin, për gruan time, për tokat e gruas time, për pallatin e gruas time, për tenderët e baxhanakut tim, për kumatim, për femijët e mi është një instrument që mund të na vlejë. Unë jam i bindur që edhe në këtë sallë mund të ketë shumë njerëz që mendojnë që baxhanaku im ka marrë vërtetë 15 milionë euro tenderë. Si sqarohet kjo, duke jua thënë unë juve, apo duke e lënë punën, duke e lënë qeverisjen e duke ndenjur të gjithë nëpër zyrë e duke shkruar komunikata çdo orë, për të gjithë llojet e gomarllëqeve dhe palaçollëqeve që nxjerr nga goja Partia Demokratike, ose çizma e Partisë Demokratike, që nxjerr nga qafa e këpucës?", u shpreh Rama. E duke folur për veting të gjithë, Rama tha: "Unë, Presidenti i Republikës, kryetari i opozitës, kunati i kryetarit të opozitës, gruoja e kryetarit të opozitës, rrethi familiar, vjehri, vjehrra ime, të gjithë, patjetër. Që të kuptojnë njerëzit se ku jemi e ku jetojmë këtu. A jemi të gjithë vërtet njësoj, apo ka ca që janë ndryshe e ca që janë ndryshe? Patjetër kryeministrat e mëparshëm, femijët e tyre. Ku udhëtojnë, çfarë shpenzojnë, sa rrinë jashtë shtetit e sa vijjnë në Shqipëri, cilët bamirës jua japin këto..."

U përjashtua nga Rama, Gjetani: Nuk kam shkelur statutin, e padrejtë

Deputeti socialist Gjetan Gjetani, i cili u propozua për përjashtim nga PS nga kryeministri Edi Rama tha dje, se vendimi është i padrejtë dhe arrogant. Në një reagim në rrjetin social "FB", Gjetani tha se socialist nuk e bëri Edi Rama, por ka qenë me të majtën edhe në ditët më të vështira të PS-së. "Vendimi i Edi Ramës, për të më larguar nga grupi parlamentar është një vendim i padrejtë. Nuk më ka bërë socialist Edi Rama, dhe nuk ka se si ai të më largojë. Socialist kam qenë në ditë të vështira të PS-së me familjen e njerëz të afërt të mi, dhe jo sot në pushtet kur ndahen tenderë e privilegje. Sot Edi Rama nuk ofroi asnjë zgjidhje për Kurbinin. Duke më sulmuar mua publikisht, ai as nuk shtoi investime, as vende të reja pune në Kurbin. Përkundrazi, shtoi vetëm një dozë tjetër të arrogancës së tij, arrogancë që e kanë dhe të besuarit e tij në Kurbin dhe kjo, jo vetëm nuk është ajo çfarë presin banorët me shumë halle, por vete problemi që prodhon edhe më shumë hendek mes qeverisë dhe njerëzve", u shpreh deputeti. "Nuk di të kem shkelur statutin për t'u përjashtuar nga PS-ja. Nëse anëtarët do të përjashtoheshin se flasin për problemet në zonën e tyre, atëherë nuk do të kishte mbetur njeri", tha ai.

ERION VELIAJ

"Nuk e diskutoj sfidën për tu përkushtuar për një fitore në 61 bashkitë tona. Ajo që diskutoj dhe duhet të mendoj është cilësia e të zgjedhurve vendorë, sidomos e këshilltarëve tanë. Ajo që kemi parë shpesh është që mundohemi të bëjmë qoka me këshilltarë, çojmë njerëz të partisë që të mos na mërziën dhe i çojmë këshilltarë kur ndërkohë shumë prej tyre nuk kanë folur asnjëherë", u shpreh Veliaj.



Shtyrja e ligjit për Teatrin, Meta: Kuvendi sovran, nuk paragjykoj vendimet

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje, se nuk mund të paragjykojë vendimin e Kuvendit, sa i përket votimit të dekretit për Teatrin. Në një prononcim për gazetaret, ndërsa ndodhej në repartin e Shërbimit Zjarrfikës në Tiranë, ku mori pjesë në fushatën për dhurimin e gjakut, Meta tha: "Kuvendi është sovran për të vendosur sipas procedurave e përgjegjësive të veta, dhe unë nuk kam asnjë koment për këtë çështje. Nuk kam asnjë arsye të paragjykoj vendimet e Kuvendit, përveçse do të dëshiroj t'i uroj Kuvendit punë të mbarë, meqenëse sapo ka riçelur punimet dhe të theksoja rëndësinë e një bashkëpunimi sa më të përgjegjshëm, sidomos për sa u takon të gjitha atyre detyrimeve dhe angazhimeve që ka Shqipëria edhe në kuadër të procesit të integritimit evropian". I pyetur në lidhje me ndryshimet që kërkohen opozita në Kushtetutë sa i përket vetingut, presidenti u shpreh: "Shpresoj në një bashkëpunim dhe në një lexim të përbashkët të atyre sfidave, me të cilat duhet të përballohet politika shqiptare në mënyrë të bashkuar, për të garantuar pikërisht çeljen e negociatave për anëtarësim vitin e ardhshëm". I pyetur për përplasjen me Kuvendin sa i takon shortit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, Meta tha: "Unë kam zbatuar dhe do të zbatoj gjithnjë ato detyrime kushtetuese dhe ligjore që ka Presidenti".

krejtësisht të panevojshme, në mos fiktive, ne nuk mund ta pranojmë në asnjë mënyrë e për asnjë arsye", u shpreh Rama. "Ne kemi nevojë të riorganizohemi rrënjësisht në territor, duke marrë eksperimentat më të mira. Mos harrojmë pasqyrën e rezultateve të zgjedhjeve të shkuara. Të mos harrojmë diferencat mes Fierit dhe Tiranës, për të marrë një shembull. Mund të marrësh shumë shembuj të tjerë. Për të kuptuar se çfarë do të thotë organizim kapilar dhe çfarë do të thotë parti e organizuar me njerëzit dhe për njerëzit. E patëm në Fier dhe morëm 10 deputetë. Nuk e patëm në Tiranë dhe morëm më pak se në Fier, në raport me votat dhe në raport me çfarë duhet të kishim marrë me gjithë

ato punë të mëdha që kemi bërë në Tiranë", theksoi dje, Rama.

KANDIDATËT

"Duhet ta fillojmë fushatën sot, edhe për një arsye tjetër. Ne nuk mundet më të jemi si vetja deri dje e si të tjerët, që listat e përfaqësuesve të këshillave bashkiakë t'i bëjmë natën e fundit, t'i bëjmë natën e fundit, t'i bëjmë sipas qejfit e t'ia faturojmë Partisë Socialiste e të mos mbajmë pastaj asnjë përgjegjësi sesi sillen, sesi kontribuojnë, se çfarë vlerë të shtuar sjellin nëpër këshillat", kërkoi Rama. Ai tha se kryetarët e bashkive duhet të fillojnë fushatën e llogaridhënies ashtu siç bëri qeveria.

VETINGU

Kryeministri përfitoi nga

Zbardhet amendamenti i PD, kush përjashtohet nga e drejta për t'u zgjedhur

Vetingu në politikë, Basha-Ramës: Nuk ka rinegociata, voto ligjin

"Për pastrimin e politikës, aksion popullor"

Valentina Madani

Demokratët depozituan dje në Kuvend nismën për ndryshime kushtetuese, që i hap rrugë vetingut në radhët e politikës. Propozimi parashikon ndërprerje të mandatit të politikanëve dhe ndalimit për t'u zgjedhur apo emëruar në funksionin publik, për të gjithë ata individë që rezultojnë me të shkuar problematike. Projektligji i PD-së përfshin edhe presidentin dhe kryeministrin. Në projektligjin e publikuar nga PD, shkruhet se: "Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, kryetari i bashkisë dhe çdo drejtues ose anëtar i institucioneve kushtetuese dhe ligjore që emërohen në detyrë me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, i nënshtrohen procesit të kontrollit të pastërtisë së figurës. Mandati i funksionarëve të zgjedhur apo emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj përfundon nëse konstatohet që janë të përfshirë në rrethin e subjekteve që kanë kontakte me persona në krimin e organizuar." Lulzim Basha, si propozues i këtij amendimi foli për domosdoshmërinë e shkëputjeve të lidhjeve që ai thotë se qeveria ka me krimin, por nuk pranoi të negociojë me kundërshtarit e tij politik për ndryshimet kushtetuese, duke i kërkuar



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë bashkëbisedimit me gazetarët

BYLYKBASHI

"Të gjitha institucionet kushtetuese janë të përfshira në këtë propozim që bëjmë ne. Shkëputja e krimin nga politika, pra të heqim krimin nga politika dhe institucionet është objektiv primar. PD dhe opozita kanë shprehur haptas një objektiv dhe vullnet, të shkëpusë lidhjet e politikës dhe institucioneve me krimin" - tha ai.

KRYEMADHI: SITUATA KRIMINALE, ALARMANTE

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, ndau dje shqetësimin për situatën kriminale në Shqipëri me raportet e Këshillit të Europës Europës, z. Andrej Hunko dhe z. Joseph O'Reilly. "Situata kriminale në vend është alarmante dhe Shqipëria ndodhet aktualisht në udhëkryqin më të rrezikshëm të saj. Mazhoranca dhe kryeministri kanë kapur Reformën në Drejtësi duke shkatërruar thelbin dhe qëllimin e reformës të miratuar me konsensusin historik të 21-22 korrikut", - tha Kryemadhi.

Ramës të ngrejë vetëm kartonë në parlament. "Ligji është negociuar njëherë, i njëjti me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ska mbetur asgjë për t'u negociuar. Kjo ose votohet, ose rrëzohet. Këtë duhet të bëjë Rama të votojë, të mos bëjë propagandë", theksoi z. Basha. Që situata në vend të ndryshojë, Basha nuk mjaftohet vetëm me vetingun. "Një aksion i fuqishëm popullor, i domosdoshëm për shkëputjet e lidhjeve të policisë me krimin. Atentat ndaj demokracisë që sot në Kuvend kemi Xhafajn, Çyrbën, Ballën, Dakon etj. Në instan-

cat qendrore e vendore, policia e lidhur me krimin bëjnë ligje dhe janë të paprekshëm", u shpreh kreu i PD-së. Demokratët nuk kanë një vendim për bojkotin e Kuvendit, pavarësisht se në dy seancat e para për këtë seion refuzuan të merrnin pjesë në parlament duke e quajtur strofull të krimin. "Ne po bëjmë ligje. Opozita në pesë ditë nga nisja e sesionit ka çuar ligje në Parlament. Kemi propozuar vetingun e politikës të lidhur me krimin, nuk duam të bojkotojmë Kuvendin. Duam ta pastrojmë menjëherë", thek-

soi z. Basha. Kreu i PD-së nënvizoi faktin se vetingu për politikanët do të jetë i njëjti me atë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku do të verifikohet pasuria për të gjitha figurat zyrtare. Ligji në fjalë përveç disa ndryshimeve, është thuajse i njëjti me atë ekzistuesin për "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Kështu, ndryshimet që reflektohen janë ato që listës i shtohen zyrtarë që nga deputetë, kryetarë bashkish, kryeministri, apo dhe anëtarë institucioneve.

PROJEKTILIGJI PD: VETING NGA META E RAMA, TE ZYRTARËT E INSTITUCIONEVE

PROJEKTILIGJI PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998 "KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 83 pika 1 dhe 177 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit.
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:
Në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
NENI 1
Fjalja e parë, e pikës 3 të nenit 45, ndryshohet si më poshtë vijon:
"3. Përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, ose shtetasit që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit".

Neni 2
Pas nenit 176 të Kushtetutës, shtohet "Pjesa e Gjashtëmbëdhjetë/1", me këtë përmbajtje:
"PJESA E GJASHTËMBËDHJETË/1
MEKANIZIMI I GARANTIMIT TË INTEGRITETIT TË FIGURËS SË FUNKSIONARIT PUBLIK
NENI 176/1

Qëllimi i kontrollit të figurës
Kontrolli i figurës ngritet me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisë vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje të funksionarëve që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të individit.
NENI 176/2

Subjektet dhe rregullat e kontrollit të figurës
Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, kryetari i bashkisë dhe çdo drejtues ose anëtar i institucioneve kushtetuese dhe ligjore që emërohen në detyrë me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave, i nënshtrohen procesit të kontrollit të pastërtisë së figurës. Subjektet e parashikuara në pikën 1, dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Nëse subjekti i përmendur në pikën 1 ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumi në favor të masës së ndalimit për t'u zgjedhur apo emëruar në funksionin publik, mbarim të mandatit apo shkarkimit nga detyra dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Nëse subjekti i përmendur në pikën 1, nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën, apo përpiqet të bëjë deklaratë të pasaktë, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumi në favor të masës së ndalimit për t'u zgjedhur apo emëruar në funksionin publik, mbarim të mandatit apo shkarkimit nga detyra dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Kur subjekti i përmendur në pikën 1, nuk justifikon ligjëshmërinë e pasurisë sipas vendimit të organit përgjegjës kushtetues, zbatohet masa e ndalimit për t'u zgjedhur apo emëruar në funksionin publik, mbarim të mandatit apo shkarkimit nga detyra. Kushtet, rregullat dhe organet përgjegjëse për zbatimin e mekanizimit të garantimit të integritetit të figurës së funksionarit publik përcaktohen me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit".

NENI 3
Pas nenit 179/b, shtohet neni 179/c me këtë përmbajtje:
"NENI 179/C

Mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi, në përputhje me procedurën e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës miraton ligjin që përcakton kushtet dhe rregullat për garantimin e integritetit të figurës së funksionarit publik".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e suportit vjetor për serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,520,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttes: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e suportit vjetor për serverat e tipit Lenovo / IBM System te Bankes se Shqiperise"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,450,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfuttes: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Rinovimi i suportit vjetor të HP Data Protector"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 04 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Pronari i "Arbri Garden", dyshohet për aktivitet kriminal në vendet e BE

Kokaina në Durrës, Arbër Çekaj mohon akuzat për trafik droge

Avokati Haxhia: Viojnë procedurat e ekstradimit nga Gjermania

Ina Allkanjari

Arbër Çekaj, i arrestuar 4 muaj më parë në Gjermani, pasi dyshohet për trafikimin e 613 kilogramëve kokainë kolumbiane në portin e Durrësit, mohon akuzat. Përmes një deklarate për mediat, avokati i tij, Maks Haxhia ka thënë se Çekaj kundërshton me forcë akuzat për trafik droge dhe se nuk ka bërë deklaratë për autoritetet gjermane. Sipas avokatit procedura e ekstradimit të tij është ende në vazhdim. Më tej Haxhia thekson se klienti i tij nuk ka përmendur emrat e shtetasve K.Boci dhe L.Morina të përmendur në shkrimin e disa mediave shqiptare. "Me cilësinë e avokatëve të shtetasit Arbër Çekaj, Prof.Dr. Ahlbrecht Rechtsanwalt dhe Dr. Basar Rechtsanwal, i janë drejtuar Prof. Dr. Maksim Haxhia me cilësinë e avokatit dhe kryetarit të Avokatëve të Shqipërisë, t'iu bëjë prezent mediave në Shqipëri dhe nëpërmjet tyre, opinionit publik shqiptar deklarata si më poshtë: "Procedura e ekstradimit është ende në vazhdim dhe z.Çekaj kundërshton me forcë akuzat për trafik droge dhe nuk ka bërë asnjë deklaratë autoriteteve gjermane. Ai nuk ka përmendur emrat e K.Boci dhe L.Morina të përmendur në shkrimin e disa mediave shqiptare, të cilët ai nuk i njeh personal-

HETIMI
Ndonëse u arrestua për llogari të drejtësisë shqiptare, në maj të 2018, Arbër Çekaj ende ndodhet në gjermani. Më herët autoritetet gjermane informuan prokurorinë shqiptare se kanë nisur hetimet për Çekajin, pasi kanë dyshime se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal edhe në territorin e tyre.



Pronari i "Arbri Garden", Arbër Çekaj

isht dhe me të cilët nuk ka pasur kurrë kontakt në jetën e tij", -thuhet në deklaratën për shtyp. Ndonëse u arrestua për llogari të drejtësisë shqiptare, në maj të 2018, Arbër Çekaj ende ndodhet në gjermani. Më herët autoritetet gjermane informuan prokurorinë shqiptare se kanë nisur he-

timet për Çekajin, pasi kanë dyshime se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal edhe në territorin e tyre. Ndërkohë nuk jepen shpjegime nëse biznesmeni, po hetohet nga gjermanët vetëm për episodin e trafikimit të sasisë rekord të drogës, apo edhe raste të tjera. Hapja e hetimit ndaj

Çekajit po vonon ekstradimin e tij ku sipas procedurës pas arrestimit të biznesmenit pala shqiptare paraqiti prova e fakte ku kërkonte që ai të ekstradohej pasi ka një urdhër arresti në mungesë si i dënuar për trafik ndërkombëtar droge. Ndërkohë të vetmit që vijojnë të mbahen

në qelietë e paraburgimit për trafikimin e drogës me vlerë 180 milionë euro, janë menaxheri i kompanisë, Donald Lushaj dhe shoferi i kamionit, Armand Pezaku. Prokuroria shqiptare ka dyshime se droga e kapur në magazinat e kompanisë "Arbri Garden", do të trafikohet drejt vendeve të BE-së, ndër

AVOKATI
Përmes një deklarate për mediat, avokati i tij, Maks Haxhia ka thënë se Çekaj kundërshton me forcë akuzat për trafik droge dhe se nuk ka bërë deklaratë për autoritetet gjermane. Sipas avokatit procedura e ekstradimit të tij është ende në vazhdim.

to edhe në Gjermani.

ARRESTIMI I ÇEKAJT

Rreth dy muaj pas kapjes së 613 kg kokainë në portin e Durrësit arrestohet në Gjermani Arbër Çekaj, pronari i firmës 'Arbi Garden', i cili ishte shpallur në kërkim pasi kishte porositur kontejnerin me banane ku u droga që vinte nga Kolumbia. Menjëherë pas operacionit policor i koduar 'Last Snow', ku u bë e mundur sekuestrimi i drogës, Çekaj u largua në gjermani dhe ndaj tij u lëshua një urdhër-arresti ndërkombëtar. Konkretisht Çekaj u kap në rrethinat e Dyselldorffit. Dyshohet se ai kishte ndryshuar identitetin nga Arbër Çekaj në Arbër Jansen, duke marrë mbiemrin e bashkëshortes së tij me origjinë daneze.

Ai u gjet i fshehur në një banesë dykatëshe dhe gjatë momentit të arrestimit mësohet se nuk bëri rezistencë.

Përcaktohet trupa gjyquese, Gentian Ternovën e rivlerëson Ina Rama

Prokurorët e Krimeve të Rënda në "sitën" e vetingut, nis hedhja e shortit për dosjet hetimore

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është në përfundim të procesit për vetimin e 57 gjykatësve dhe prokurorëve të niveleve të larta si dhe atyre që kandidojnë për institucionet e reja, si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe ai gjyqësor. Ndërkohë përmes një shkrese dërguar prokurorisë së përgjithshme, Komisioni ka kërkuar nga ky institucion marrjen e masave për hedhjen e shortit në institucionin e akuzës për Krime të Rënda. Burimet bënë me dije se shorti pritet të hidhet javën e ardhshme, në 15 shtator. Në këtë mënyrë përzgjidhen dosjet për secilin prokuror, e mbi këtë bazë bëhet edhe vlerësimi profesional për secilin prej tyre. Raporti që përpilohet nga prokuroria e përgjithshme, vlerësohet më pas nga Komisioni bashkë me komponentët e tjerë, për të vendosur mbi fatin e subjektit, nëse konfirmohet ose jo në detyrë. Por nga hedhja e shortit, deri në momentin kur prokurorët do të ftohen në seancë dëgjimore publike, me gjasë do të kalojnë disa muaj, të cilët do të jenë vendimtarë për secilin nga



RAPORTI

Raporti që përpilohet nga prokuroria e përgjithshme, vlerësohet më pas nga Komisioni bashkë me komponentët e tjerë, për të vendosur mbi fatin e subjektit, nëse konfirmohet ose jo në detyrë.

prokurorët. Prokuroria për Krime të Rënda është një nga institucionet e vendosur në qendër të vëmendjes, për shkak të disa çështjeve të rëndësishme që ka nën hetim: Si ajo për ish-ministrin e Brendshëm Saimir

Tahiri, dosja e 3.4 milionë eurove që u kapën në Toyota Yaris' apo hetimet për 613 kg kokainë kolumbiane që u zbulua në portin e Durrësit dhe u sekuestrua në magazinat e Arbër Çekajit në Maminas. Nga ana tjetër

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka hedhur shortin për të përcaktuar trupën e cila do të marrë në shqyrtim ankesën e prokurorit pranë Prokurorisë së Apelit, Gentian Trenova. Mësohet se trupa gjyqesive do të kryesohet nga ish-kryeprokurorja Ina Rama, relatore do të jetë Natasha Mulaj, ndërsa anëtarë do të jenë: Albana Shtylla, Ardian Hajdari dhe Luan Daci. Kujtojmë se më datë 20 qershor Trenova u shkarkua me vendim të KPK-së. Nga verifikimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Trenova rezultoi se nuk justifikonte pasurinë për apartamentin si dhe vlerën prej 12 mijë euro të parapaguar në 2007. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konstatoi se prokurori kishte mungesë të burimeve financiare të ligjshme, kishte fshehur pasurinë dhe kishte kryer deklaratim të rremë. Sa i përket aftësisë profesionale, Trenova kishte pushuar hetimet për pasurinë e një personi të arrestuar nga policia greke me kanabis dhe një pistoletë.



Vdekja e Aida Çajkës në maternitet, prokuroria e Tiranës çon për gjykim mjekjen dhe dy infermierët

Kur kanë kaluar rreth dy vite nga vdekja e Aida Çajkës bashkë me foshnjën e saj në maternitetin "Koço Glizheni" në kryeqytet, prokuroria e Tiranës ka dërguar në gjyq një mjekje dhe dy infermiere Konkretisht mjekja e QSUT dhe dy infermierët dyshohen për 'mjekim të pakujdesshëm'. Sipas prokurorisë, nëna shtatzënë nuk ka marrë ndihmën mjekësore sipas protokollit. Ngjarja ndodhi më 16 shtator 2016, ku 35-vjeçarja nga Paskuqani ka humbur jetën gjatë lindjes bashkë me foshnjën. Mësohet se në këtë datë rreth orës 05.00 në Spitalin-Universitar Obsetrik-Gjinekologjik "Koço Glizheni" është konstatuar vdekja e pacientes Aida Çajka dhe e fëmijës se saj seksi femër. E ndjera Çajka, e cila ishte në muajin e 9 të shtatzënisë, është paraqitur në datë 15.09.2016 rreth orës 22.30 në këtë spital në gjendje të rënde shëndetësore e shoqëruar nga të afërmit e saj. Në vijim, e ndjera është vizituar nga mjekët obstetër gjinekologë, të cilët, pasi janë konsultuar ndërmjet tyre, pavarësisht gjendjes së rëndë të pacientes, e kanë dërguar pacienten për një kontroll në QSUT për konsultë kardiologu. Pas vizitës së bërë nga kardiologu, e ndjera është dërguar në SU Shefqet Ndroqi, për vlerësim nga pneumologu, ku pas vizitës është dërguar përsëri në Spitalin-Universitar Obsetrik-Gjinekologjik, "Koço Glizheni" në gjendje shumë të rënde shëndetësore. Pas mbërritjes në spital rreth orës 04.00 në gjendje shumë të rënde, e ndjera i është nënshtruar ekzaminimeve nga ku ka rezultuar se fetus(i fëmija) ishte i vdekur. Nga mjekët është inicuar një ndërhyrje kirurgjikale, por 35-vjeçarja ka ndërruar jetë gjatë kësaj ndërhyrjeje.

Llogariten sipërfaqet takuese për pronarët, poseduesit marrin certifikatën e pronësisë mbi tokën

Qeveria, tapi për truallin për 300 pronarë

Lista me përfituesit dhe parcelat në të gjithë vendin

Ornela Manjani

Këshilli i Ministrave ka miratuar të drejtën për kalimin e pronësisë të parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale. Bëhet fjalë për rreth 300 pronarë në të gjithë vendin, kur personat që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapinë mbi truallin. Sipas listës së miratuar nga qeveria dhe të botuar në Fletoren Zyrtare, mësohet se është përllogaritur sipërfaqja takuese, ku në pjesën më të madhe të raste ka ndryshime në 2 m² që përfitojnë pronarët.

TAPIA
Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon

dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar marrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen

më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depotizuar brenda afatit të vetedeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë, përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

LISTA EMERORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PER KORRIGJIM

NR. RENDOR	DREJTORIA	KORRIGJIMI	EMER	ATESH	MBEMER	NR. PROTOKOLLIT VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PARURBE	SIPERFQJA E PARCELLES NDERTIMORE PER TAPIA (PROJEKTI WP)	
										NR. RENDOR
1	DURRES	ISHTE	PATMEK	LIJAN	BUKU	1414		13/25	337/51	
		BEHET	AUREL	PATMEK	BUKU	1414	8511	13/25	337/51	
		ISHTE	KIPON	SHAQIR	HADJA	8014		17/238	264/31	
		BEHET	KIPON	SHAQIR	HADJA	8014	8518	17/238	264/31	
3	ELBASAN	ISHTE	VILLI	MIRYAT	KOLONJARI	1824		3/66	486	
		BEHET	PADIL	MIRYAT	KOLONJARI	1824, 8436	8527	3/66	486	
4	ELBASAN	ISHTE	SALI	CANI	BARAMI	1954		8527	30871	485/3
		BEHET	SAJME	HEJAN	BOCI	1954	8527	30871	485/3	
		ISHTE	URIM	XHEJAN	ISTREPI	440		8340	4/387	248/2
		BEHET	URIM	XHEJAN	ISTREPI	440	8340	4/387	248/2	
6	TIRANE JUG	ISHTE	ROLAND	BENNIK	MEYTA	428		8190	4/210	291/7
		BEHET	BENNIK	MEYLOM	MEYTA	427		8190	4/210	342/4
		ISHTE	ROLAND	BENNIK	MEYTA	427,428,3735	8190	4/210	500	
		BEHET	ROLAND	BENNIK	MEYTA	427,428,3735	8190	4/210	500	
7	DURRES	ISHTE	IZJA	IDRIZ	XHEMOLLARI	2227		25/3	337	
		BEHET	ERVIS	IDRIZ	XHEMOLLARI	2227	8511	25/3	337	
		ISHTE	DERGUP	ALI	KUQI	268		25/30	237	
		BEHET	DERGUP	ALI	KUQI	268	8511	25/30	237	
		ISHTE	DREJAN	NUREJON	BEBRUI	3742		16/182	202	
		BEHET	DREJAN	NUREJON	BEBRUI	3742	8511	16/182	202	
		ISHTE	GRAMOZ	TAJAN	ZONIA	3742		27/34	202	
		BEHET	GRAMOZ	TAJAN	ZONIA	3742	8511	27/34	202	
		ISHTE	DORGO	VELI	ZGURU	7255		9/125	278	
		BEHET	DORGO	VELI	ZGURU	7255	8511	9/125	278	
		ISHTE	IBRAHIM	IBRAHIM BILALI	IBRAHIM	1027		8270	6/375	141
		BEHET	VANILLAG	SOJIB	DAMO	1027	8270	6/375	141	
12	TIRANE VEBI	ISHTE	NEJIM	FRANK	MIKA	1655		8310	7/340	374
		BEHET	NEJIM	FRANK	MIKA	1655	8310	7/340	374	
		ISHTE	EMRIK	NEJIM	MIKA	1058		8310	7/340	374
		BEHET	EMRIK	NEJIM	MIKA	1058	8310	7/340	374	
14	TIRANE VEBI	ISHTE	AREEN	RAMADAN	ALLA	653		8210	2/386	262/9
		BEHET	AREEN	RAMADAN	ALLA	653	8210	2/386	262/9	
15	DURRES	ISHTE	GJOVALIN	NIKOLL	SHKURTI	1409		85/112	230	
		BEHET	AREEN	NIKOLL	SHKURTI	1409	8517	85/112	230	
		BEHET	ERI	NIKOLL	SHKURTI	1409	8517	85/112	430	
16	DURRES	ISHTE	BENNIK	PODI	BEGU	1000		62/109	373	
		BEHET	BENNIK	PODI	BEGU	1000	8511	62/109	373	
		ISHTE	MEYAT	LIRA	LIKA	3464		56/204	512	
		BEHET	MEYAT	LIRA	LIKA	3464	8517	56/204	512	
18	ELBASAN	ISHTE	ALBERT	LEP	BOGURI	8030		2/322	172/3	
		BEHET	ALBERT	LEP	BOGURI	8030, 20020	8522	2/322	172/3	
		ISHTE	HAMCA	HEJGURAN	SHAVIARI	1476		8190	7/450	138/4
		BEHET	HAMCA	HEJGURAN	SHAVIARI	1476	8190	7/450	138/4	
20	ELBASAN	ISHTE	OSMAN	PAIK	POCI	1233		3/253	136/4	
		BEHET	OSMAN	PAIK	POCI	1233, 1404	3446	3/253	372/9	
		ISHTE	HAMIT	BENJEN	NOZI	680		58/187	388	
		BEHET	HAMIT	BENJEN	NOZI	680	8517	58/187	388	
21	DURRES	ISHTE	OSMAN	PAIK	POCI	1233		3/253	136/4	
		BEHET	OSMAN	PAIK	POCI	1233, 1404	3446	3/253	372/9	
		ISHTE	HAMIT	BENJEN	NOZI	680		58/187	388	
		BEHET	HAMIT	BENJEN	NOZI	680	8517	58/187	388	
22	DURRES	ISHTE	OSMAN	PAIK	POCI	1233		3/253	136/4	
		BEHET	OSMAN	PAIK	POCI	1233, 1404	3446	3/253	372/9	
		ISHTE	HAMIT	BENJEN	NOZI	680		58/187	388	
		BEHET	HAMIT	BENJEN	NOZI	680	8517	58/187	388	
23	DURRES	ISHTE	OSMAN	PAIK	POCI	1233		3/253	136/4	
		BEHET	OSMAN	PAIK	POCI	1233, 1404	3446	3/253	372/9	
		ISHTE	HAMIT	BENJEN	NOZI	680		58/187	388	
		BEHET	HAMIT	BENJEN	NOZI	680	8517	58/187	388	
24	ELBASAN	ISHTE	OSMAN	PAIK	POCI	1233		3/253	136/4	
		BEHET	OSMAN	PAIK	POCI	1233, 1404	3446	3/253	372/9	
		ISHTE	HAMIT	BENJEN	NOZI	680		58/187	388	
		BEHET	HAMIT	BENJEN	NOZI	680	8517	58/187	388	

25	ELBASAN	ISHTE	APERDITA	BESIM	MUKA	196		8520	3/236	216
		BEHET	APERDITA	BESIM	MUKA	196	8520	3/236	158	
		ISHTE	ASTRIT	IBRAHIM	BRASHA	784		8520	12/294	446
26	ELBASAN	BEHET	MARGARIT	SHEPQET	BRASHA	784		8520	12/294	149
		ISHTE	ZHEVRIK	MIRYAT	BEZATI	6109		8520	16/568	104/4
27	ELBASAN	BEHET	ZHEVRIK	MIRYAT	BEZATI	6109, 205, 13564		8520	16/568	240
		ISHTE	ZHEVRIK	MIRYAT	BEZATI	6109, 205, 13564		8520	16/568	240
28	KAVAJE	ISHTE	SHAH	REHAT	DIMRI	2346		8552	14/171	242/46
		BEHET	SHAH	REHAT	DIMRI	2346		8552	14/171	242/46
29	DURRES	ISHTE	GIN	LEK	MENGAJ	4783		8513	8/172	389
		BEHET	GIN	LEK	MENGAJ	4783	8516	8/172	389	
		ISHTE	LEJSH	LEK	MENGAJ	4783		8517	4/130	442
30	DURRES	BEHET	HEKURAN	MUSTAFA	ZENILI	3650		8517	4/130	442
		ISHTE	HEKURAN	MUSTAFA	ZENILI	3650	8518	4/130	442	
31	TIRANE JUG	BEHET	RAMIZ	MUHAMMED	MECILI	230		8170	9/335	389/6
		ISHTE	RAMIZ	MUHAMMED	MECILI	230, 993	8170	9/335	389/6	
32	TIRANE JUG	ISHTE	MIRIAN	GEJTM	DIRMIRI	216		8180	5/305/1	298/6
		BEHET	MIRIAN	GEJTM	DIRMIRI	216	8180	5/305/1	298/6	
33	DURRES	ISHTE	HAMIT	VEBI	ISLAMI	3909		8518	34/31	497
		BEHET	HAMIT	VEBI	ISLAMI	3909	8518	34/31	497	
		ISHTE	EDUARDET	HAMIT	ISLAMI	3909		8518	34/31	497
34	DURRES	ISHTE	LIJAN	BEAT	MYRTAJ	381		8516	1/174	330
		BEHET	LIJAN	BEAT	MYRTAJ	381	8516	1/174	330	
35	ELBASAN	ISHTE	DIJELL	SHPER	PROGROMI	264		2908	15/128	252/2
		BEHET	DIJELL	SHPER	PROGROMI	264	2908	15/128	252/2	
36	TIRANE JUG	ISHTE	XHEMAL	SHABAN	CEKA	1821		3976	213/28	26
		BEHET	XHEMAL	SHABAN	CEKA	1821, 165, 165/1	3976	213/28	26	
37	TIRANE KURALE	ISHTE	ASTRIT	EKBEREM	TRINGI	875, 6277		2367	50/741	373
		BEHET	ASTRIT	EKBEREM	TRINGI	875, 6277	2367	50/741	373	
38	KORÇE	ISHTE	Dhimitri	Liger	Vanko	218		8563	4/661	448
		BEHET	Dhimitri	Liger	Vanko	218	8563	4/661	448	
		ISHTE	Thoma	Thoma	Vanko	218		8563	4/661	1463/3
39	TIRANE JUG	ISHTE	MAKSI	MAMUTI	SHIBRI	4001		3866	367/134	502/2
		BEHET	MAKSI	MAMUTI	SHIBRI	4001	3866	367/134	502/2	
40	TIRANE JUG	ISHTE	QAMIL	GANI	DINA	1173		3976	333/100	500/3
		BEHET	QAMIL	GANI	DINA	1173, 1173	3976	333/100	500/3	
41	KUCES	ISHTE	XHEVDET	SYL	POGA	17		2280	4/100	94/05
		BEHET	XHEVDET	SYL	POGA	17	2280	4/100	64/18	
		ISHTE	AMRULLI	BENI	CEKA	33		2280	8/104	300
43	DURRES	ISHTE	KARAFEL	MYPTAR	KUKA	4208		8518	17/34	304
		BEHET	KARAFEL	MYPTAR	KUKA	4208, 13309, 5994	8518	17/34	304	
		ISHTE	JAKUP	MYPTAR	KUKA	4208		8518	17/34	304
44	DURRES	ISHTE	QAMIL	MYPTAR	KUKA	3440		8518	4/237	271
		BEHET	QAMIL	MYPTAR	KUKA	3440, 4776, 914	8518	4/237	271	
45	ELBASAN	ISHTE	NEJIM	HALLI	KOLLONARI	2042		8527	10/108	465/9
		BEHET	NEJIM	HALLI	KOLLONARI	2042, 2923, 2922, 397	8527	10/108	465/9	
46	DURRES	ISHTE	HAJRI	BUJAR	BEKTESHI	639		8511	2/401	468
		BEHET	HAJRI	BUJAR	BEKTESHI	639	8511	2/401	468	
		ISHTE	SALAM	BUJAR	BEKTESHI	639		8511	2/401	468
47	DURRES	ISHTE	GIURI	ZYLFI	DEJDA	9795		8517	58/175	264
		BEHET	GIURI	ZYLFI	DEJDA	9795	8517	58/175	264	
48	DURRES	ISHTE	REFIJE	BENI	DEJDA	983		8517	58/174	498
		BEHET	REFIJE	BENI	DEJDA	983	8517	58/174	498	
49	DURRES	ISHTE	ZAIM	HASAN	TUSKU	8034				

Ornela Manjani

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka përgatitur një skemë, sipas së cilës u bën me dije të gjitha bizneseve që kanë xhiro vjetore deri në 2 milionë lekë detyrimet që kanë për tatime e taksa. Përgatitja e skemës ka nisur pas një fushate që kanë nisur tatimet me mbështetjen e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për informimin të gjerë për tatimpaguesit.

PLATFORMA

Platforma e informimit ofron informacion të plotë dhe të detajuar mbi 11 kategori të ndryshme tatimpaguesish. Tatimet kanë dhënë fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë që kanë një xhiro vjetore të biznesit nga 0 deri në 2 milionë lekë. Person juridik quhet një shoqëri tregtare që preferon të bëjë biznes si person juridik dhe jo si individ, person fizik. Harton një statut të shoqërisë

Tatimet, personat juridikë, nga 0 në 2 mln lekë ja sa taksa duhet të paguani

Bizneset me xhiro deri në 2 mln, skema e re e tatimit

Llogaritja e të gjitha detyrimeve që duhen derdhur

si individ/person juridik ose me individë të tjerë/persona të tjerë juridikë dhe merr përgjegjësi për detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë me të gjitha pasuritë e biznesit. Personi juridik regjistrohet si i tillë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nëse një person juridik ka një xhiro vjetore të biznesit nga 0 deri në 2 milionë lekë, ai nuk është subjekt i TVSH-së (përveç kur blen mallra ose shërbime importi për t'i shitur ose ushtron profesion që i nënshtrohet TVSH-së pavarësisht xhiros) dhe tatimit mbi fitimin, por ka detyrime për të deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi dhe Tatimin në Burim (nëse i ka si përgjegjësi tatimore) si dhe ka detyrimin për të deklaruar Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin. Për këtë kategori, Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin është me shkallë 0%.

TATIMET
Platforma e informimit ofron informacion të plotë dhe të detajuar mbi 11 kategori të ndryshme tatimpaguesish. Tatimet kanë dhënë fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë që kanë një xhiro vjetore të biznesit nga 0 deri në 2 milionë lekë.

DOKUMENTET QË DUHEN AFISHUAR NË AMBIENTET E BIZNESIT:

1. Certifikata e regjistrimit (NIPT-i).
 2. Lista e çmimeve të shitjes për çdo mall/shërbim që ofron.
 3. Njoftim-kujdes për klientët që të marrin kuponin tatimor për blerjet me para në dorë si dhe që kanë të drejtë për të mos kryer transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor.
 9. Merr faturë tatimore të thjeshtë ose me TVSH (në varësi të përgjegjësisë tatimore të shitësit) për çdo blerje të kryer për biznesin tënd.
- Deklarimi i të punësuarve dhe të larguarve nga puna dhe i pagave të tyre:**
1. Marrja në punë dhe largimi nga puna deklarohen në logarinë elektronike:
 2. 1 ditë para marrjes në punë.
 3. Brenda 10 ditëve nga data e largimit nga puna.
 4. Njihen si shpenzime të zbritshme vetëm pagat që paguhen nëpërmjet sistemit bankar.
- Detyrimet tatimore që duhen paguar**
Shuma e detyrimeve tatimore, llogaritet duke shumëzuar shumën (shkallën) mbi të cilën llogaritet tatimi me bazëllën tatimore të caktuar për secilin lloj të tatimit.

Tabela 2-Detyrimet Tatimore për personat juridikë me xhiro vjetore mbi 0 - 2 milionë lekë

Nr.	Lloji i detyrimit	Shkalla tatimore	Shuma mbi të cilën zbatohet shkalla tatimore
1.	Kontribute për sigurime shoqërore të punëmarresit	24.5%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale dhe jo mbi pagën maksimale mujore (24,000-105,850 lekë)
2.	Kontribute për sigurime shëndetësore të punëmarresit	3.4%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale mujore (24,000 lekë)
3.	Tatim mbi të ardhurat nga punësimi të punëmarresit	0% 13% 23%	Paga mujore bruto deri në 30,000 lekë; Pjesa e pagës mujore bruto mbi 30,000-130,000 lekë Pjesa e pagës mujore bruto mbi 130,000 lekë
4.	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0%	Fitimi bruto (para tatimit)
5.	Tatim në burim	15%	Shuma bruto e pagesës për individë të përegjistruar

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë

Ish-të përndjekurit, 100 përfituesit e dëmshpërblimit

Rreth 100 ish-të dënuar politikë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri, duhet hapin një numër llogarie për të marrë paratë. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë brenda 30 ditëve për të marrë dëmshpërblimin. Ndërkohë që të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive.

ISH-TË DËNUARIT
Ministria e Financave u kërkon përfituesve të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë brenda 30 ditëve për të marrë dëmshpërblimin. Ndërkohë që të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive.

ri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimit të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative, thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

PËRFITUESIT E DËMSHPËRBLIMIT

Nr.Dosje	Emer	Atesi	Mbiemer			
6523	DASHURI		DERVISHI	20268	ARBEN	HAXHI REXHEPI
20268	VALENTINA		MULLAJ	20268	EMINGJELUSHE	COLLAKU
15520	MANDALENA		NIKOLL PEPA	20268	EMIN	FERIT HILA
20268	PLUTURA	HASAN	PITKA	20268	RIZA	SHEFKI ISA
20285	BASHKIM	MYNIR	GURI	20268	XHEMAL	RIZA ISA
20285	VERI	MYNIR	GURI	19915	BURBUQE	SULEJMAN GJIZA
20285	FALMUR	MYNIR	GURI	18134	MARIJANA	DAJA
20285	RUHI	MYNIR	GURI	21591	XHEMAL	RIZA ISA
20285	VJOLLCA	MYNIR	GURI	21523	MERUSHE	CELAJ
15315	LLESH	PAL	NDRECA	21440	ALBINA	NIKE PACAJ
5339	MIRELA	XHEVDET	VRAPI	20122	HASAN	ALI MAKSUTTI
8460	HRISANTHI	JANI	MELLO	20806	RREGJINA	NIKOLL GIACI
18498	QEMAL	LECINI		20806	VERE	VALTERI
15440	PAVLI	VASIL	PAPAHRISANTHU	20806	NHAT	KURTI
17138	DORINA	BERHAMI		20806	BEHXIHE	ADEM KOLA
17138	NEXHMI	SABRI	BERHAMI	20806	ILIR	RIZA NOGA
17138	SADLJE	RAMADAN	BERHAMI	14568	KRISTINA	LLOKMAN ZENELI
17138	SULEJMAN	SABRI	BERHAMI	14898	ENVER	KARAFIL MANCE
19114	VALDETE	SHEFQET	ZALLI	10815	RAPI	HEKURAN GOZHINA
15520	GJELINE	NIKOLL	GJINAJ	7610	SUZANA	MURAT HIDRI
15520	GASPER	ULDEDAJ		19238	FRROK	PJETER FRROKU
10523	GRAMOS	FASLLI	LLAPERI	19238	NDUE	NDOCI
16664	CAZMIR	LIKA		21379	XHAFAER	RIZA LLUKA
16664	ABDURRAHMAN	LIKA		21379	XHEMILE	SHPEEND LLUKAJ
16664	DASHURIE	LIKA		21379	SABRIJE	LLUKAJ LLUKAJ
18275	DRITE	HASAN	GASHI	20807	YLBER	VALTERI
12410	ELSA	JOVANI		8565	AHMET	HAMIT ALLA
8644	PELLUMB	KULAJ		8565	NEXHMIJE	LALA
523	LUPTI	HAXHI	KURTI	8565	MEREME	HAMIT BALLA
523	ZENEPE	KOCI		8565	HAJRLJE	ALLA
523	BEXHET	HAXHI	KURTI	8565	HANIFE	HAMIT SINA
6523	SAIMIR	XHEMIL	KOKLA	8565	XHANE	BARDDHI
5339	ELIRA	XHEVDET	BREGU	20645	SHUKRIJE	KOCEKU
8924	MUHARREM	SELIM	HOXHAI	21379	ALIDA	LLUKAJ ZENELI
9097	KASEM	QAZIM	KERCIKU	18341	KADENE	AHMET ZENELI
9553	LULE	NDQJ		20268	RINA	HAXHI VITO
10222	BARDHOK	DED	BUSHI	20268	KADRI	TEKI ISA
10225	FANE	PANO	CARO	20268	NESIMI	TEKI ISA
10225	MANTHA	NIKO	CARO	18134	LULE	VELI ISA
4523	RYZHDIJE	JAKUP	MUZHACI	18134	NESIMI	TEKI ISA
4394	OSMAN	ISLAM	HASTOCI	18134	KADRI	TEKI ISA
19766	FATIXHE	MUHARRREM	SHEHU	9374	URANIE	VANGJEL MEMA
10133	NEXHMI	IBRAHIM	EREBARA	9374	SOKRAT	VANGJEL DERVISHI
10133	NAZE	KADRI	DOCI	15718	MUHAMED	ABAZ MUJA
10133	KADRI	PETRIT	KALLCISHTA	1666	MEHMET	SETT DADA
10133	SHPRESA	PETRIT	GJURA	19238	NEKI	DALIP LAZRI
14299	SKENDER	BAJRAM	GJOCAJ	17138	BEDRRIJE	KETRUSHA
14299	MUJ			17138	BUKURRIJE	BATHORJA
				20285	SAZAN	HAMZA DRINI

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër dje ka lënë në burg tre nga katër personat e arrestuar nga policia, RENEJA dhe FNSH pas vrasjeve mafioze të ndodhura kohët e fundit në qytetin verior. Ndërsa, njëri nga personat që u prangos gjatë operacionit "Forca e ligjit" është lënë i lirë. Bëhet fjalë për 29-vjeçarën Astmer Bilali (ish-kampion boks). Togat e zeza të Shkodrës vendosën masën e sigurisë "Arrest shtëpie" me mbikëqyrje policore. Ndërkaq, trupi gjykoes la në burg me afat 30 ditor tre shtetasit e tjerë: Ilir Bajri, Emrah Plaku dhe Erogen Brajoviq, të cilët akuzohen nga prokuroria për armëmbajtje pa leje dhe grup të

Lihet i lirë ish-kampioni i boksit, Astmer Bilali

Arrestimet e të "fortëve" në Shkodër, gjykata lë 30 ditë në burg Ilir Bajrin dhe 2 të tjerë

strukturuar kriminal. Por dy akuzat e ngritura nga prokurorja Esmeralda Ndoci duket se nuk kanë bindur gjyqtaren Irida Kacerja, e cila la në qeli tre nga katër të arrestuarit vetëm për akuzën e armëmbajtjes pa leje. Seanca për masën e sigurisë për katër shtetasit u zhvillua me detyrë të mbyllura dhe nën masa të rrepta sigurie. Astmer Bilali, Ilir Bajri, Emrah Plaku dhe Erogen Brajoviq ishin të pranishëm në sallën e gjyqit bashkë me avokatët

mbrojtës. Lulzim Karim ka në mbrojtje 36-vjeçarën Erogen Brajoviq, ndërsa tre të tjerët mbrohen nga avokati Bujar Hoti. Gjatë seancës, prokuroria kërkoi "Arrest me burg" për katër shtetasit në fjalë, por pala mbrojtëse ka kundërshtuar një gjë të tillë. Në fund Bilali u lirua me masën e sigurisë: "Arrest shtëpie". Ndërkaq, afat 30 ditor për tre të tjerët do të shërbejë që gjykata të njihet me aktet e ekspertimit për sekuestrimet që ka bërë

policia dhe provat që prokuroria pretendon. Sipas palës mbrojtëse organi i akuzës nuk ka prova për katër të arrestuarit, ndaj kërkuan lirinë e tyre. Avokatët mbrojtës deklaruan para gjykatës se armët e sekuestruara nuk kanë lidhje me shtetasit e arrestuar, sepse në dokumentacionin përkatës nuk thuhet se ku janë gjetur këto armë dhe të kujt mund të jenë. Sa i përket 6 mjeteve të blinduara që janë sekuestruar, sipas



avokatëve mbrojtës janë me dokumentacionin përkatës dhe se nuk ka ndonjë shkelje ligjore. Seanca gjyqësore për vendosjen e masës së sigurisë ishte parashikuar që të niste në ora 13:00, por ka nisur për

ARRESTIMI

Policia e Shtetit në bashkëpunim me blutë e Shkodrës dhe forcat speciale ndërhyjnë në lajjet e të "fortëve" në Shkodër. Katër persona u arrestuan, ndërsa u sekuestruan armë, mjete të blinduara, një sasi parash dhe sende të tjera. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se u kryen kontrolle në 20 banesa e lokale tregtare, të përdorura prej personave të dyshuar si anëtarë të grupeve kriminale.

mbi një orë me vonesë dhe ka përfunduar rreth orës 16:00. Për afro 3 orë rruga e gjykatës së Shkodrës (shumë afër qendrës së qytetit) është monitoruar gjatë gjithë kohës nga policia. **se.ni.**

Vjehri i viktimës: Dhëndri u vra tek sa po fliste në telefon me time bijë

Ekzekutimi i 43-vjeçarit Alket Muho në Memaliaj, arrestohen babë dhe bir

Autorët qëlluan për vdekje kushëririn për motive pronësie

TEPELENË

Një ditë pas ekzekutimit me plumb në kokë të 43-vjeçarit Alket Muho në fshatin Rabie në Memaliaj, policia ka bërë të mundur identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës mbrëmë bënë me dije se pas hetimeve intensive u zbuluan autorët e ngjarjes së rëndë. Bëhet fjalë për 59-vjeçarën Hetem Muho dhe djalin e tij 20-vjeçar Dino Muho (kushërinj të largët me viktimën), banues në Sarandë. "Ndalimi i tyre, (babë e bir) u bë pasi dyshohet se në bashkëpunim me njëritrin, ditën e djeshme (të enjten) rreth orës 11:35, kanë vrrarë me armë zjarri shtetasin A.M., 43 vjeç, banues në fshatin Rabie, Tepelenë. Kjo ngjarje ndodhi në vendin e quajtur "Bolovec" të fshatit Rabie. Nga tërësia e veprimëve dyshohet se dy autorët e kanë vrrarë shtetasin A.M. për shkak të konflikteve të përsëritura me motive pronësie, në fshatin e origjinës së autorëve. Materialet procedurale në ngarkim të shtetasve të ndaluar i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprat penale: 'Vrasje me dashje kryer në bashkëpunim', 'Prodhim e mbajtje pa leje armëve luftarake e municionit', 'Prodhim e mbajtje pa leje armëve të gjuetisë dhe sportive', 'thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkohë, pak orë para kapjes së autorëve, në lidhje me këtë ngjarje të rëndë ka reaguuar babai i viktimës, i cili u shpreh se ende nuk e di se pse iu vra djali. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", Gjolek Muho deklaroi se nuk kanë pasur konflikte me askënd, ndërsa i bëri apel shtetit që të vërë në pranga autorët e krimit. "Nuk kam ndonjë dyshim pse mund të ketë



Babai i viktimës, Gjolek Muho duke folur për "GSH"



Vjehri i viktimës, Riza Ardita duke folur për "GSH"

ndodhur vrasja e tim biri. Nuk kishim konflikte të hapura që mund të na sillte këtë fatkeqësi, këtë gjëmë. I bëj apel shtetit të gjendet autori. Djalin ma kanë vrrarë me dy armë, me cifte dhe me automatik. Fillimisht e kanë qëlluar me automatik dhe më pas me cifte në kokë,

pohoi babai i 43-vjeçarit. Gjithashtu, në lidhje me vrasjen e Alket Muho ka reaguuar dhe vjehri i viktimës. Në një lidhje telefonike për "News24" Riza Ardita pohoi se nuk kishte asnjë informacion për lidhje të dhëndrit të tij me kanabisin. Ai sqaroi se Alketi kishte marrë disa



43-vjeçari i vrrarë, Alket Muho

plumba dhe se ka qenë e bija që e njoftoi për vrasjen e tij. Në një intervistë për "GSH", vjehri i viktimës u shpreh se Alket Muho ishte duke folur me vajzën e tij në telefon kur është qëlluar me armë. Ndërsa, mësohet se gruaja e 43-vjeçarit ka deklaruar se në momentin që po fliste me të shoqin ka dëgjuar krizma si dhe ka dëgjuar bashkëshortin t'u thotë disa njerëzve: "C'bëni kështu more çuna".

Zoti Riza, jeni në dijeni nëse dhëndri juaj ka pasur konflikte?

Jo, nuk di të ketë pasur konflikte më parë. Ka pasur para 2-3 vitesh me një fqinj për një çështje pronësie, por konflikte të tjera nuk di. Ai ka vënë në dijeni policinë për shqetësimin e tij.

Kur ndodhi ngjarja dhe kush e gjeti viktimën?

Ngjarja ndodhi dje (të enjten) rreth orës 11:00. Dhëndrin e gjeti të vrrarë vajza

ime. Ajo ishte duke folur me të në telefon kur ka dëgjuar krizma armësh. Ime, ka dëgjuar burrin e saj të thotë: Oooo ca bëni o çuna. Më pas është fikur telefoni, ndaj vajza ka shkuar menjëherë atje dhe ka gjetur të shoqin të vrrarë me kallashnikov. Në drejtim të tij ishin derdhur 20-30 plumba. Ia kishin hequr komplet syrin.

Di gjë nëse Alketi ka informuar policinë për parcelat me hashash?

Jo. Nuk kam të dhëna për këtë punë. Nuk di të ketë dëshmuar për këtë punë. Jam i bindur se ai s'kishte lidhje me drogën.

Kur e keni takuar Alketin për herë të fundit?

Para tërë ditësh, para se të ndodhte vrasja..

Ku dyshoni?

Dhëndri ka pasur konflikte pronësie me djalin e plakës fqinje. Kishte konflikte për një rrugë, ndaj dyshoj se mund të jenë ata autorët.

SHKURT

Mashtroi qytetarët duke iu marrë para, pranga juristit të Hipotekës

KORÇË - Policia e Korçës ka arrestuar juristin e Hipotekës, Elvis Gjata, pasi akuzohet për mashtrim. Mësohet se 31-vjeçari u prangos mbrëmjen e së enjtes, ndërsa janë shpallur në kërkim shtetasit: E.F., 32 vjeç dhe K.G., 30 vjeç, të dy banues në Korçë. Sipas burime policore, këta tre persona në bashkëpunim mes tyre, nëpërmjet mashtimit, dyshohet se në muajin maj të vitit 2018, i kanë përveçuar shumë prej 8000 euro, me qëllim zgjidhjen e një problemi gjyqësor, shtetas D.H., 36 vjeç, banues në Librazhd. Materialet për veprimet të mëtejshme i kaluan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kapet i kërkuar, në vitin 2017 iu gjet në kamion 425 kg kanabis

VLORË - Një 26-vjeçar ka përfunduar në pranga, pasi ishte shpallur në kërkim për trafik droge. Në kuadër të operacionit të koduar "THE TRUCK" u bë e mundur kapja e Albano Rakipit, banues në Vlorë. Ai ishte shpallur në kërkim, pasi më datë 29 janar të vitit të kaluar, gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës, në mjetin kamion-trailer me targë "AA 8220S/AD801", në pronësi të firmës së tij, u gjet dhe u sekuestrua një sasi prej 425 kg e 650 gr kanabis sativa. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.79, datë 22.03.2018, ka caktuar ndaj shtetasit Albano Rakipi masën e sigurisë "Arrest me burg".

Kreu i Shoqatës së Bashkive: Nuk kemi asnjë reagim deri më tani nga Ministria e Financave

Taksa e pronës, Haxhimali: 60 bashki paguajnë me vlerën e tregut

“Po zbatohet metodologjia e re”

60 bashki në vend, përveç Bashkisë së Tiranës, e mbledhin taksën e pasurisë me metodologjinë e re, e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2018. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, Agron Haxhimali, bën me dije se bashkitë e kanë përfunduar metodën e re dhe qytetarët në rrethe po paguajnë në bazë të vlerës së pronës, ndërsa sipas tij, Bashkia e Tiranës po pret që të caktohet një agjent kombëtar për mbledhjen e saj. “Në Bashkinë e Tiranës vazhdon të na vijë taksa e pronës për banesat tona në faturën e ujit me metodologjinë e vjetër. Ndërsa bashkitë e tjera kanë filluar ta zbatojnë metodologjinë e re dhe janë komplet në harmoni, në korrektësi me zbatimin e ligjit dhe të udhëzimit për metodologjinë e re. Në shumicën e rasteve, agjent për bashkitë është SHA-ja e ujësllës kanalizimeve, që është në varësi dhe në pronësi të bashkisë. Në disa bashki të tjera, kjo taksë mbledhet nëpërmjet zyrës së taksave të bashkive. Në disa të tjera është e alternuara: një pjesë e mbledh SHA-ja e ujësllës për zonën që ajo mbulon dhe pjesa tjetër, ku SHA-ja e ujësllës nuk ka klientë, e mbledh



Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, Agron Haxhimali

nëpërmjet zyrës së taksave”, u shpreh Haxhimali për Scan. Ndërsa, shoqata i ka dërguar një letër Ministrisë së Financave, pak ditë më parë, me anë të së cilës

refuzon OSHEE si agjent kombëtar të mbledhjes së kësaj takse, ende nuk ka marrë një përgjigje. Haxhimali thekson se sugjerimet do bëhen prezente edhe në

mbledhjen e Këshillit Konsultativ të Biznesit. “Kemi bërë propozimet tona, të cilat konsistojnë në faktin që OSHEE nuk duhet të jetë agjenti i vetëm dhe ko-

REAGIMI
Nuk kemi asnjë reagim nga Ministria e Financave, por presim që gjatë shtatorit të kemi një mbledhje të Këshillit Konsultativ ku të zgjedhurit vendorë do të bisedojnë me pushtetarët qendrorë dhe do ta fusin në axhendë propozimin e Shoqatës së Bashkive”, deklaroi ai.

mbëtar. Mund të jetë një agjent, të cilin mund ta zgjedhin vetë bashkitë nëpërmjet vendimit të Këshillit dhe ta negociojnë kryetarët. Dhe propozimi tjetër ka qenë që

edhe pagesa që do të mbajë OSHEE-ja mos të jetë fikse 4%, por secila bashki në raport me rrethanat që ka mund ta negociojë, mund të jetë më pak me qëllim që bashkitë të kursejnë sa më shumë nga taksat e qytetarëve. Ku jemi në këtë fazë? Nuk kemi asnjë reagim nga Ministria e Financave, por presim që gjatë shtatorit të kemi një mbledhje të Këshillit Konsultativ ku të zgjedhurit vendorë do të bisedojnë me pushtetarët qendrorë dhe do ta fusin në axhendë propozimin e Shoqatës së Bashkive”, deklaroi ai. Vendimi që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të caktohet si agjent kombëtar për mbledhjen e taksës së pasurisë, ka ngjallur reagime të forta nga pushteti vendor, por edhe opozita.

Vendimi i Këshillit të Ministrave/ kategoritë përfituese

Pagesë 300-6000 lekë në muaj për qytetarët që marrin shërbim rezidencial

Të gjithë ata qytetarë që marrin shërbim të kujdesit shoqëror rezidencial do të përfitojnë edhe një pagesë shtesë çdo muaj. Sipas vendimit më të fundit të Këshillit të Ministrave, kategoritë në nevojë mund të përfitojnë shërbime parashoqërore që kanë të bëjnë me informimin dhe këshillimin si dhe shërbime në komunitet. Këto të fundit janë shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët. Pas gjashtë muajsh nga marrja e këtij vendimi të gjithë personave përfitues të shërbimit rezidencial publik, do t'u jepet, për shpenzime personale, një shumë parash. Personat e moshuar që nuk kanë të ardhura, që janë të vendosur në shërbimin rezidencial për të moshuarit, do të përfitojnë gjashtë mijë lekë në muaj, kjo është dhe vlera më e lartë që jepet për këtë kategori. Ata që do të paguhën më pak janë



MASA E PAGESES

Ata që do të paguhën më pak janë fëmijët e moshës 2-5 vjeç, që do të përfitojnë 300 lekë në muaj. Pagesa do të përfitojnë edhe kategoritë e tjera si personat që marrin shërbim në qendrat e zhvillimit, viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit.

fëmijët e moshës 2-5 vjeç, që do të përfitojnë 300 lekë në muaj. Pagesa do të përfitojnë edhe kategoritë e tjera si personat që marrin shërbim në qendrat e zhvillimit, viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit. Respektivisht pagesat për këtë kategori

do të jenë një mijë dhe tre mijë lekë. Këto pagesa për shpenzimet të kujdesit shoqëror në institucione publike rezidenciale dhe komunitare do të indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.



Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania



CALL FOR RESEARCHERS

Research projects on Transitional Justice

The OSCE Presence in Albania, in co-operation with Konrad-Adenauer-Stiftung, are launching a Call for Applications for research projects on transitional justice, this will include an autumn school to be held from 26th to 30th November 2018 in Tirana, Albania and the pursuit of academic research projects over a period of 12 months.

We look forward to your application if you:

- Have completed an undergraduate or graduate degree in law, history, social sciences, political sciences or international relations with good results;
- Have an interest in academia and research;
- Have a sound understanding of research methods and proven experience in empirical research;
- Have a demonstrated interest in transitional justice and dealing with the past;
- Have working knowledge of the English language.

Applicants must be available during the period 26 – 30 November 2018 to participate in an autumn school on Transitional Justice and research methodology. The participation in the autumn school is a requirement in order to be eligible as participant.

Application procedure and deadlines

The Call for the Transitional Justice research project is now open. All interested candidates can apply online, by completing the application form through this link: <https://www.surveymonkey.com/r/77DRKZN>

The application must be submitted by 07 October 2018, latest at 23:59 Central European Time.

Working Language:

The working language of the autumn school will be English.

Further information

For further information please email at: law-al@osce.org



do të jetë: kurrikula bërthamë dhe me zgjedhje, miratuar me urdhrin nr. 12789 prot., datë 28.12.2017. "Java mësimore ka 30-32 orë mësimore. 30 orë në javë shkolla detyrimisht i plotëson me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje, ndërsa 2 orë të tjera i mundësojnë sh-

kollës zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore. Nxënësi ka detyrimin të zhvillojë 30 orë në javë për secilin vit shkollor, si dhe 18 orët e shërbimit komunitar", -thuhet në udhëzimin e publikuar në fletoren zyr-

tare. Në kombinimin e lëndëve me zgjedhje, shkolla duhet të bëjë kujdes të mos tejkalojë totalin 11-13 orë të kurrikulës me zgjedhje. Shënim: Në rastet kur në kurrikulën me zgjedhje në klasën e 12-të nxënësi zgjedh të zhvillojë lëndë të cilat janë me numër çift orësh, ai mund të zhvillojë dhe deri në 31 orë mësimore në javë, të vlerësuara me notë.

MËSIMET, PUSHIMET DHE PROVIMET

Sipas udhëzimit në arsimin bazë, mësimet do të fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 12 qershor 2019, ndërsa pushimet do të fillojnë në 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019. Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 13-30 qershor 2019. Në arsimin e mesëm të lartë, mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 19 qershor 2019, ndërkohë për maturat, viti shkollor fillon më 17 shtator 2018 dhe mbaron më 4 qershor 2019. Provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen në periudhën 6-30 qershor 2019.

STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR 2018-2019:

-Në arsimin bazë

- a) Mësim: Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 12 qershor 2019.
- b) Pushime: Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019.
- c) Provime:
 - Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 13-30 qershor 2019.
 - Rregullorja e zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2019 dhe udhëzimet përkatëse do të miratohen nga ministri.

Në arsimin e mesëm të lartë

- a) Mësim: Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe mbarojnë më 19 qershor 2019. Për maturat, viti shkollor fillon më 17 shtator 2018 dhe mbaron më 4 qershor 2019.
- b) Pushime: Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019. c) Provime: Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 6-30 qershor 2019.

-Në arsimin profesional

- a) Mësim: Mësimet fillojnë më 17 shtator 2018 dhe përfundojnë:
 - a.1 Më 19 qershor 2019, për nxënësit e klasave të 10-ta (për të gjitha strukturat), për nxënësit e klasave të 12-ta (për strukturën 2+2) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (për strukturën bllok 4-vjeçare).
 - a.2 Më 7 qershor 2019, për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (struktura 2+1+1) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta (struktura 2+2). a.3. Më 28 maj 2019, për të gjithë nxënësit maturantë.
- b) Pushime: Fillojnë më 22 dhjetor 2018 dhe mbarojnë më 6 janar 2019. c) Provime:
 - c.1. Provimet përfundimtare të nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 10-21 qershor 2019.
 - c.2. Provimet përfundimtare të nivelit III zhvillohen në periudhën 29 maj-4 qershor 2019.
 - c.3 Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 6-30 qershor 2019.

Nr.	Lëndët	Orë/javë
1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	4
2	Gjuhë shqipe dhe lexim letrar	5
3	Matematikë	4
4	Dituri natyre	2
5	Vendlindje	2
6	Edukatë shoqërore	1
7	Edukim figurativ	1
8	Edukim muzikor	1
9	Aftësim teknologjik	1
10	Edukim fizik	3
	Gjithsej	24

e) Në klasat I, II, III, IV dhe VI, VII, VIII, IX të shkollave të pakicave kombëtare do të zbatohet plani mësimor si më poshtë:

Nr.	FUSHAT/LËNDËT	KLASAT								
		I	II	III	IV	VI	VII	VIII	IX	
1.	Gjuhët dhe komunikimi	8/9	11	12	11	10	11	10	10	10
1.1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	8/7	6	5	4	4	4	4	3	3
1.2	Gjuhë shqipe	0/2	5	5	5	4	5	4	5	4
1.3	Gjuhë e huaj			2	2	2	2	2	2	2
2.	Matematikë	4	4	4	4	4	4	4	4	4
3.	Shkencat e natyrës	1	1	1	2	2	4	6	6	6
3.1	Dituri natyre	1	1	1	2					
3.2	Fizikë					1	2	2	2	2
3.3	Kimi							2	2	2
3.4	Biologji					1	2	2	2	2
4.	Shoqëria dhe mjedisi	1	1	1	2	3	5	6	6	6
4.1	Gjeografi					1	2	2	2	2
4.2	Edukim për shoqërinë	1	1							
4.3	Qytetari			1	1	1	1	1	1	1
4.4	Histori				1	1	2	2	2	2
4.5	Histori e Greqisë/Histori e Maqedonisë (sh-RJM)									1
4.6	Gjeografi e Greqisë/Gjeografi e Maqedonisë (sh-RJM)									1
5.	Arte	2	2/3	3	2	2	2	2	2	1
5.1	Muzikë	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.2	Art pamor	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.3	Kërcim		0/1	1						
5.4	Teatër					1				
6.	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2	2	2	2	2	2	2
7.	Teknologji dhe TIK	1	1	1	2	2	1	1	1	1
7.1	TIK	1	1	1	1	1	1	1	1	1
7.2	Aftësim teknologjik praktik					1	1			
8.	Kurrikula me zgjedhje	1	1	2	2					
	SHUMA (orë/javë)	19/20	22/23	25	27	26	29	31	30	

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Nr.	FUSHAT/LËNDËT	KLASAT					
		10		11		12	
		Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore
1.	Gjuhët dhe komunikimi	2	72	2	72	4	136
1.2	Letërsi	-	-	-	-	2	68
1.3	Gjuhë e huaj e dytë	2	72	2	72	2	68
2.	Matematikë	-	-	-	-	2(A)	68(A)
3.	Shkencat e natyrës	-	-	-	-	12	408
3.1	Fizikë	-	-	-	-	4	136
3.2	Kimi	-	-	-	-	4	136
3.3	Biologji	-	-	-	-	4	136
4.	Shoqëria dhe mjedisi	-	-	-	-	12	408
4.1	Shkenca sociale (Sociologji, Psikologji) ¹⁰	-	-	-	-	2+2	68+68
4.2	Histori	-	-	-	-	4	136
4.3	Gjeografi	-	-	-	-	4	136
5	Arte ¹¹ (Teatër, Muzikë, Art pamor)	2	72	2	72	2	68
6	Teknologji dhe TIK	-	-	1	36	4	136
6.1	TIK	-	-	1	36	2	68
6.2	Teknologji	-	-	-	-	2	68
7	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	1	36	1	36	1	34
8	Module kurrikulare ¹²	2	72	2	72	Max 8	Max 272

PLANI MËSIMOR I GJIMNAZIT

Nr.	Fushat/lëndët	Klasat					
		10		11		12	
		Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore
1.	Gjuhët dhe komunikimi	7	252	7	252	7	238
1.1	Gjuhë shqipe	2	72	2	72	2	68
1.2	Letërsi	2	72	2	72	2	68
1.3	Gjuhë e huaj e parë	3	108	3	108	3	102
2.	Matematikë	4	144	4	144	4(B) ⁵ ose 6 (A+B)	136 (B) ose 204 (A+B)
3.	Shkencat e natyrës	6	216	6	216	-	-
3.1	Fizikë	2	72	2	72	-	-
3.2	Kimi	2	72	2	72	-	-
3.3	Biologji	2	72	2	72	-	-
4.	Shoqëria dhe mjedisi	6	216	6	216	3	102
4.1	Shkenca sociale (Qytetari ⁶ , Filozofi ⁷)	2	72	2	72	-	-
4.2	Histori	2	72	2	72	-	-
4.3	Gjeografi	2	72	2	72	-	-
4.4	Ekonomi	-	-	-	-	3	102
5	Teknologji dhe TIK	2	72	1	36	-	-
5.1	TIK	2	72	1	36	-	-
6	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	3	108	3	108	3	102
	KURRIKULA BËRTHAMË (SHUMA)	28	1008	27	972	17-19	578-646
	KURRIKULA ME ZGJEDHJE	2	72	3	108	13-11	442-374
	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE⁸	0-2	0-72	0-2	0-72	0-2	0-68
	TOTALI (nr. i orëve javore gjithsej)⁹	30-32	1080-1152	30-32	1080-1152	30-32	1020-1088

TEATRI

PROTESTA PËR TEATRIN

Balerina italiane dhe Irma Libohova i bashkohen kauzës

Fatmira Nikolli

Dita e 85-të e protestës për mbrojtjen e dy teatrove kombëtare, që një ligji i kthyer me dekret nga presidenti iu kanos të ardhmen, ka ngjitur në skenë tri balerina italiane dhe këngëtare shqiptare, Irma Libohova. Ndonëse dekreti pritet të diskutohet në Kuvend, artistët që i kanë nisur protestat në muajin shkurt me takime të përjavshme e prej 85 ditësh përditë kanë vendosur të mos dorëzohen. Fjalime e performanca artistike u kanë zënë vendin artistëve që në këta muaj u tërhoqën nga mbrojtja e godinave historike.

NË MBËSHTETJE TË KOSOVËS

Alert Çeloaliali në fillim të protestës së djeshme tha se vijmë prapë këtu për ndërgjegjësim e për të mbrojtur çka është e jona dhe e të gjithëve ne.

“Çështjet që na takojnë kërkojnë një kohezion të përgjithshëm. Është hera e parë që një protestë zgjat 85 ditë pas 13 javësh takimesh një herë në javë. Një element i rëndësishëm për vrasjen e frikës në një vend me liri shprehjeje. Duhet të mësojmë nga Kosova se si luftojnë së bashku për atë që është e të gjithëve”. Me të thënë këtë, Çeloaliali lexon letrën që artistët grevistë kosovarë të gjitha artet skenike i dërgojnë ministrit kosovar Kujtim Gashi, ku kërkohej mbrojtje institucionale e ligjore, ngritje e pagës bazë, për çka është gënjyer për muaj e muaj me radhë. Këshilli grevist i sindikatave të artit ka shpallur grevë të përgjithshme duke pezulluar çdo aktivitet artistik deri në plotësimin e kërkesave.

PERFORMANCAT

Paraditen e djeshme u bë me dije se trupa e baletit modern italian “ResExten-

sa” dhe Irma Libohova do të jenë në shesh në mbrojtje të teatrove kombëtare

“Jam këtu në shenjë respekti për bashkëshortin, për të gjithë artistët e kauzën e tyre”, tha Irma Libohova me t’u ngjitur në skenë. Ajo shtoi se erdhi “në mbështetje të kauzës së artistëve duke qenë se im shoq ka qenë aktor. Jam në mbrojtje të kauzës, në mbrojtje të institucioneve tona dhe jashtë çdo kornize politike”.

Më herët tri balerinat e “ResExtensa”, interpretuan një pjesë kontemporane. Pjesa zgjati pothuaj një orë me një koncept kushtuar femrës si qenie që jep jetë. E nisur në terr, tri balerinat italiane dhanë mesazhe për mbrojtjen e jetës dhe në fund u mbyll me tekstin “Shpëtoni artin dhe bukurinë dhe ji i ëmbël” nën dritat që zbeheshin. “Jeta ka nevojë për një trup, por ju mbrojtini e dua jini edhe trupat e tjerë”, tha Elisa Barucchieri që ishte edhe koreografe e baletit



Dita e 85-të, Irma: Jam në mbështetje të kauzës pa korniza politike



“Prospekti i dritës”, nën konceptin se krijesa e parë që drita.

Ditën e enjte, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka bërë me dije se solidarizohet dhe i bashkohet thirrjes së banorëve të Kukësit për të protestuar në 17 shtator kundra taksës së padrejtë në Rrugën

e Kombit. “Qytetarë të Tiranës e gjithë Shqipërisë, është jetike të mbështesim njëri-tjetrin në kauza të tilla të drejta. Vetëm të bashkuar do mund të detyrojmë qeveritë e këtij vendi të sprapsen nga vendime të tilla. Bashkohuni me qytetarët

e Kukësit për të mbrojtur edhe të drejtat tuaja!”, shkroi në faqen e saj Aleanca.

Po të enjten në takimin e përnatshëm, Aleanca bëri thirrje që askush të mos frikësohet nga investimet në art e kulturë, qoftë edhe kur kryhen me fonde publike. Robert Budina tregoi se si këto investime jo vetëm që mund të kthejnë mbrapsht fondet e investuara, por të krijojnë fitim për artistët

dhe komunitetet e përfshira në xhirimet e filmave. “Ama, si në çdo fushë, ka një kusht: menaxhim i lirë dhe i pavarur - diçka që qeveria aktuale e përbuz teksa po përpigjet të kontrollojë çdo aktivitet që ndodh sot në vend”, vërejtji Aleanca duke shtuar se për të justifikuar shembjen e Teatrit, qeveria përdorte rëndom justifikim se nuk kishte fonde dhe se ky ishte një investim tepër i madh.

Kastriot Çipi shpjegoi në prezantimin e tij, se Shqipëria nuk harxhon për artin as aq sa harxhon Maqedonia - një vend me popullsi dhe GDP më të ulëta se ne. Akoma më tej, Maqedonia po hap salla të reja në zonat e banuara nga shqiptarët. Në Shqipëri po i mbyllim. “Kur as standardet e Maqedonisë nuk kapim dot, është e qartë që mungesa e fondëve është justifikim e jo problem”, u tha atë mbrëmje.

NJË KARTOLINË E VEÇANTË E KRISTO LUARASIT DHE CIGARESHITËSI I MAJESTIKUT

Nën titullin “Kartë postale (e dëmtuar) me pamje nga procesi i grirjes së duhanit” në njësinë e ruajtjes nr. 1324 të Fototekës së AQSh ruhet, sikundër e thotë edhe titulli, një kartolinë. Është sistemuar në Fototekë në strukturën “Industria kimike dhe ushqimore” për shkak të imazhit që paraqet: një djalosh duke prerë duhan. Në qoshen ku zakonisht vendoset pulla kartolina ka pësuar një dëmtim mekanik, me gjasë për shkak të grisjes së pullës nga ndonjë i interesuar vetëm për të. Mirëpo, nga pas kartolina bart një tekst aspak të jashtëzakonshëm për nga përmbajtja, por për nga natyra intime, kthehet në një “futje hundësh” të

padëmshme në marrëdhënien mes dy njerëzve. Pikërisht kjo kureshtje na shtyu të kërkojmë pak për marrësin e kësaj kartoline. E dërgon Kristo Luarasi nga Sofja e Bullgarisë për Lekë Margjinin në Tiranë. Kristo Luarasi është patrioti dhe intelektual i mirënjohur i viteve 1920-’30, kurse Lekë Margjini është patrioti dhe ushtaraku jo fort i njohur për këdo. Margjini ishte nga Oroshi i Mirditës. U shkollua si ushtarak në Bullgari dhe shërbeu për disa vite në ushtrinë Bullgare. Shërbeu si oficer në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës, pak më pas datës së mbërritjes së kartolinës në Tiranë. Më pas u radhit me forcat pro Fan



Nolit më 1924. Pas kthimit të Leka Zogut në Shqipëri emigroi në Itali, nga ku u kthye më 1939. U emërua nën-prefekt i Strugës më 1941, kurse më 1943 u burgos nga nazistët në Prishtinë. Pas luftës u vendos në Korçë ku, në moshë të thyer, u martua me të bijën e Sotir Pecit. E mbylli jetën duke punuar si cigareshitës në një kioskë pranë Kinema Majestikut në Korçë. Vallë, a do të kishim mësuar për këtë korrespondencë miqsh, përveçse duke shfletuar rastësisht lëndën arkivore të Fototekës së AQSh? Përgjigjen nuk e japim dot në formë absolute. Mund të themi, ama se fondi arkivor i AQSh mbetet ngaherë in-

teresant dhe fort i pasur me të dhëna historike. Teksti i kartolinës i transliteruar: “Sofie, 17/ III/ 921. Fort i dashtuni Lekë, të mar në gryk me shum mall. Poliksena, Margarita, Sevoja, etj., miq e t’afër m të falen. Mora letërn e Z(ot)nis suaj e jam i gëzuar që je shënosh e mir e që s’më kini harruje. Ne harim shenosh e mir në Korçë. Gjith miqtë e gjërnjtë i gjeta shëndoshë. Për atë që folëm udhës bisedova në Vlorë, po mjerisht nuk shkrojtën. Kam qëllim të vinj andej që të shihemi, të fala ty e gjith miqtë aty, i yti, Kr(isto) P. Luarasi”.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 02.10.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I për shpëtim e pasurisë të paluajshme Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie E90, volumni 9, faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi. Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankand 25.200 (Njëzet e pesë mijë e dyqind) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 01.10.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I III për shpëtim e pasurisë të paluajshme Truali me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtesë me sipërfaqe 128 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillestare në ankand 81,043 (Tetëdhjetë e një mijë e dyzet e tre) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shpëtim të pasurisë të paluajshme:
- "Apartament", me Nr. 11/33+122 pasurie, me sipërfaqe 73 m², Zona Kadastrale 8663, volumni 36, faqe 92, regjistruar në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruktion" Sh.p.k. Cnemi fillestar i ankandit është 20.440 Euro;
- "Apartament", me Nr. 11/33+123 pasurie, me sipërfaqe 73 m², Zona Kadastrale 8663, volumni 36, faqe 93, regjistruar në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruktion" Sh.p.k. Cnemi fillestar i ankandit është 20.440 Euro.
- "Njës", me Nr. 11/33-N11 pasurie, me sipërfaqe 26 m², Zona Kadastrale 8663, volumni 36, faqe 45, regjistruar në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme Vlorë në pronësi të Shoqërisë "Elvi Konstruktion" Sh.p.k. Cnemi fillestar i ankandit është 14.540 Euro.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.09.2018.
Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 14/11, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë, tel 04 45 00 460, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 626

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Sami

E shtunë 8 Shtator 2018

SHFAQET SUPER I DASHURUAR,
STRESI: KUR E KE SHPIRTIN PLOT



KLAUDIA KALIA:

ME KANE OFRUAR PARA PER TE HEQUR DORE NGA MODELINGU

*"Unë përfaqësuese e Shqipërisë,
ambasadore e paqes në botë"*



MERKATO E MEDIAS

Çfarë po ndodh me lëvizjet e figurave të njohura të ekranit

Rikthehet Adi Krasta, "News 24" sjell risi me "A show" dhe programet e 2019-ës



news 24

PLAS DEBATI

U PUTH ME NJE VAJZE,
RREFEHET LINDA HALIMI



Rrëfhet misi: Si erdhi oferta nga shtëpia më e famshme e modelingut në botë

KLAUDIA KALIA:

Më kanë ofruar para për të hequr dorë nga modelingu



Pamela Aliaj

Konkurset e bukurisë janë një ndër eventet më të parapëlqyera në botën e modës dhe modelingut, por jo të gjithë i njohin vështirësitë që një konkurrencte mund të hasë gjatë rrugës. Vitin e shkuar ajo konkurroi për të njëjtin pozicion si edhe këtë vit, por për shkak të moshës, nuk arriti të merrte pjesë. Këtë vit, Klaudia Kalia, bukuroshja nga Tirana, do të jetë përfaqësuese e "Miss Grand International 2018" në Mynmar në Tajlandë. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Klaudia ka folur për prapaskenat e të qenurit një konkurrencte në rang botëror. Ajo që tërhoqi më tepër vëmendje ishte fakti se i kishin ofruar lekë në këmbim të pjesëmarrjes në botën e artit. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

“

“Unë përfaqësuese e Shqipërisë, ambasadore e paqes në botë”





Jeni sërish pjesëmarrëse e “Miss Grand International 2018”, kësajradhe në Myanmar. Si ju përzgjedhën dhe si ndiheni që do përfaqësoni Shqipërinë?

Siç e kam shprehur në postimin që kam publikuar, është “Miss Grand International” në Tailandë, duke qenë më e pëlqyera ‘online’ vitin e shkuar, vendosën të me përzgjidhnin së bashku me producentin shqiptar, Aleks Tanushi, si konkurrenten më të denjë për përfaqësimin në një kompeticion kaq të rëndësishëm botëror.

Me çfarë po merret tani Klaudia?

Për momentin, normalisht që po merrem me përgatitjet që më duhen për ta përfaqësuar Shqipërinë në mënyrën më të mirë.

Mendoni se “gabimet” e së shkuarës në konkurs do të përsëriten?

Nuk mendoj se kemi hapësira për të gabuar, pasi unë po mundohem që çdo gjë të jetë në rregull.

Këtë vit nisni studimet në USA për gazetari. A do vijoni me modelingun, apo do ta përmbyllni ëndrrën me këtë konkurs?

Qëllimi im është që të shkoj përtej këtij kompeticioni, pasi ky kompeticion më hap dyert për shumë mundësi të tjera. Por sigurisht pa lënë mënjanë studimet.

Ku e sheh veten Klaudia në të ardhmen?

Të flasësh për veten nuk është e thjeshtë, sepse kam qëllim që fjalët e mija të mos ngelen thjesht fjalë, por të



bëhen vepra në të ardhmen. Por ajo çfarë unë e shoh veten është ambasadore e paqes, si përfaqësuese e Shqipërisë në të gjithë botën. Ashtu siç është qëllimi i këtij

kompeticioni.

Cila është shtypa apo muza jote më e madhe?

Shtypa ime më e madhe sigurisht që është besimi që kam për të mos hequr dorë

nga pasioni im për modën. Sigurisht, kjo edhe nga mbështetja e familjes.

A ka ndodhur t’ju ofrojnë lekë për të hequr dorë nga ëndrra juaj? Nëse po, çfarë konkretisht?

Po, më ka ndodhur. Një ofrim i tillë që unë mos të isha pjesë e artit ku mund të kisha çdo gjë në këmbim, por qëllimi im nuk është paraja, por mbi të gjitha plotësimi i vetes sime si individ dhe pasioni që t’i arrij vetë gjërat.

Thatë se ishit pjesë e një studioje modelingu para disa muajsh. Vijon bashkëpunimi? Keni pasur oferta më joshëse? Cila në veçanti?

Jo, nuk jam pjesë e asaj studioje modelingu dhe ofertat janë vërtet të shumta. Bëhet fjalë për oferta jashtë Shqipërisë, nëpër agjencitë, le të themi, ndër më të mëdhatë. Një ndër ofertat më të arsyeshme për momentin është në agjencinë ndërkombëtare “Talent. Model. Management”, që më është of-

ruar nga vetë drejtori i agjencisë, e cila është me bazë në Rusi.

Do të shkëputeni për në SHBA vetëm për studime. Do e vijoni modelingun edhe atje? Keni lidhur ndonjë kontratë me ndonjë fotograf që jeton aty?

Qëllimi njëherë është shkolle, por për më tepër, le t’ia lëmë kohës. Modelingun do ta vazhdoj, por nuk kam një kontratë për arsye sepse dua t’i shoh nga afër gjërat.

Klaudia modele, gazetare apo... ?

Klaudia modele, gazetare... e lindur për art.

A është dikush në jetën tuaj? A ka ndikuar ai në vendimet tuaja?

Në jetën time është familja ime. E vetmja që ka ndikim në vendimet e mija.

Cila ka qenë dilema më e madhe e Klaudias dhe si e keni zgjidhur atë?

Nuk kam pasur ndonjë dilemë të madhe. Dihet që jeta ka ulje dhe ngritje, por falënderoj Zotin që deri tani ka shkuar çdo gjë mirë.





Ish-banorja e 'BB' merr një surprizë të shtrenjtë për ditëlindje, kush është "boss"-i që ia ka dhuruar

Vetëm para pak ditësh ajo festoi ditëlindjen. Ish-banorja e "Big Brother 9" ka befasuar me postimin e saj të fundit në "Instagram". Xheni Mhillaj ka festuar ditëlindjen dhe ka marrë një super dhuratë. Ajo është përfolur mjaft për ndarjen nga Benardi, partneri i saj në "Big Brother". "Dhurata e ditëlindjes", shkruan Xheni si mbishkrim të fotos... dhe në foto shfaqet një orë e markës "Rolex". Kush mund t'ia ketë dhuruar këtë dhuratë kaq të shtrenjtë bukuroshes?

U kap "mat" me një djalë, Arilena Ara rrëfen të vërtetën

Vetëm para pak ditësh u publikuan disa foto të këngëtares së hitit "Nëntori", Arilena Ara, ku shfaqej në krahët e një djali "misterioz". Të dy dukeshin mjaft të lumtur në krahët e njëri-tjetrit, teksa po shijonin pushimet në një jaht. E pyetur nga një media rozë lidhur me këto foto, Arilena ka pranuar lidhjen duke treguar se shumë shpejt do të zbulojë edhe sekretin. "Shumë shpejt djali nuk do jetë më misterioz për ju. Do ta zbulojmë edhe sekretin", - shprehet Arilena. Më tej, Arilena tregoi se për karrierën e saj qëllimi kryesor është përfundimi i albumit muzikor, i cili do të vijë në gjuhën angleze.




Shfaqet super i dashuruar,

STRESI:

Kur e ke shpirtin plot



Kur e ke shpirtin e plotsuar senet tjera duken krejt hajgare ne ket jet



Pas njoftimit të fundit se nuk do të postonte më foto të tijat personale, por do të merrej me albumin e fundit që po përgatit, reperi Stresi duket se nga ndryshuar mendim. Në një video të fundit të hedhur në "Instastory", ai shfaqet më i dashuruar se kurrë. Në video reperi shfaqet së bashku me të fejuarën e tij Kejsin, të dy të lumtur me njëri-tjetrin. Krahas postimit Stresi ka shkruar: "Kur e ke shpirtin e plotësuar, sendet e tjera të duken hajgare në këtë jetë", - përfundon reperi. Kejsi dhe Stresi janë prej kohësh së bashku dhe duket se lidhja e tyre tashmë është e konsoliduar dhe e lumtur.

Plas debati se u puth me një vajzë, rrëfëhet më në fund Linda Halimi

Edhe pse kishte një kohë të gjatë që ishte shkëputur nga tregu i muzikës, këngëtarja Linda Halimi publikoi projektin më të ri muzikor që mban titullin "Murda". Në klipin e këngës, Linda shfaqet pranë një modeleje bionde, teksa shkëmbejnë puthje me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, klipi u komentua shumë në media duke krijuar edhe polemika. Në një intervistë për një media rozë, Linda ka treguar arsyen përse zgjodhi një prezantim të tillë. "Thjesht, sepse doja të provoja diçka të re. Në jetë ne rritemi, zhvillohemi, eksperimentojmë, provojmë gjëra të reja. Sepse do të ishte monotoni e madhe nëse do të bënim të njëjtat gjëra gjithmonë. Dhe unë jam e bekuar që çdo ditë kam mundësinë të bëj gjëra të reja", - thotë ajo duke qeshur. Më tej, ajo tregoi se kënga është sensibilizim për komunitetin "LGBT".



Poston fotot e rralla të dasmës, mallëngjehet Jona Spahiu: E bekuar!

Edhe pse kanë kaluar 3 muaj, duket se shija e dasmës së saj private ende nuk është shuar. Ishte pikërisht në muajin qershor të këtij viti kur u mbajt dasma e shumëpërfolur e moderatores Jona Spahiu dhe partnerit të saj, Frenkli Ymeri. Në fillim ata vendosën të mos publikonin asnjë detaj nga dasma, por tani që ka kaluar pak kohë, moderatorja simpatike nuk po i 'kursen' më disa nga momentet kulminante. Nëpërmjet disa postimeve në "Instagram", moderatorja ka ndarë me ndjekësit e saj foto mjaft të ëmbla nga ceremonia e martesës. Në fillim shfaqet vetëm ajo dhe barku i rumbullakosur dhe më pas janë fotot e mrekullueshme të çiftit krahas familjarëve të tyre. "Nuk ka nevojë për ditë speciale, për të kujtuar emocione speciale. E bekuar", - shkruan Jona për krahas fotove. Kujtojmë se moderatorja është në muajt e fundit të pritjes së ëmbël dhe shumë shpejt do të sjellë në jetë fëmijën e saj të parë.



Pushimet mbaruan? Jo për Armina Mevlanin, që po i shijon në maksimum

Pas tre muajve të nxehtë të verës, të gjithëve na duhet t'i rikthehemi rutinës së përditshme. Por mesa duket, disa nuk janë rikthyer ende. E kemi fjalën gjithnjë për VIP-at tanë, të cilët kanë mundësi të shijojnë në maksimum edhe në fillim vjeshte ditët e fundit të relaksit. Blogerja e njohur, Armina Mevlani, është duke shijuar momente të paharrueshme në bordin e një anijeje si një nga ambasadoret e firmës së njohur "Monet". Pas organizimeve të ndryshme të realizuara gjatë vitit, nuk kishte si të mungonte dhe 'relaksi' dhe festa e organizuar nga vetë firma për ambasadoret në botë. Nga fotot e postuara në "Instastory" duket se blogerja është duke i shijuar në maksimum këto ditë.



Pushime-mania? Kida poston foto 'të nxehta' në "Instagram"

Mesa duket këngëtarja e njohur, Kida po e përfundon verën ashtu siç e ka filluar, me pushime. Ajo vazhdimisht publikon fotografi nga vendi ku qëndron, ndërkohë që këtë herë ka zgjedhur Turqinë. Në fotot e postuara shfaqet në bikini të ndryshme secilën herë, kurse vëmendjen padyshim e merr trupi i saj në super-formë, sidomos në pozën e fundit në bikini të bardha, ku i duket barku i tonifikuar. Kida siç duket nuk e ka ndërmend të kthehet në shtëpi deri sa të përfundojë vera. Për t'u pasur zili!



Rikthehet Adi Krasta, "News 24" sjell risi me "A show" dhe programet e 2019-ës

MERKATO E MEDIAS

news 24

Çfarë po ndodh me lëvizjet e figurave të njohura të ekranit

“Udhëtimi im përfundon këtu”! Ja VIP-at e njohur që do sjellin risi këtë shtator në televizione

Pamela Aliaj

Edhe pse ka nisur shtatori, ende nuk ka përfunduar merkatoja televizive. Të shumtë janë figurat e njohura që kanë lëvizur nga një media në një tjetër për të nisur një rrugëtim të ri, por ka edhe nga ata që kanë hedhur hapat e parë në botën e medias.

Disa ishin të paparashikuara, ndërkaq që të tjera i shohim dhe si vendime të mirëqena pas një periudhe të gjatë si imazh i një medie. Do të na çudiste nëse do të shihnim se Blendi Fevziu për shembull do të "braktiste" "Klanin", apo Alban Dudushi "Top Chanel".



AULONA MINGA

“braktis” TVSH-në

Ajo që vërtet na bëri përshtypje ishte largimi i një prej imazheve të televizionit shqiptar. Të gjithë ishin mësuar ta shihnin gjithnjë në ekranin e TVSH-së, por Aulona Minga



vendosi ta ndërpresë këtë rrugëtimin e saj në këtë televizion ku drejtonte emisionin e pasdites. Gazetarja e njohur, pas 20 vitesh punë ka dhënë dorëheqjen nga TVSH-ja dhe ka pranuar një ofertë tunduese nga televizioni i ri "CNN", i quajtur ndryshe "A2", i cili ka mbledhur rreth vetes një sërë emrash të njohur të ekranit. Ndërkaq, Aulona nuk është e vetmja që do t'i bashkohet këtij televizioni të ri. Denisa Pasholli, imazhi i lajmeve në "Top Channel", me një eksperiencë 15-vjeçare në televizion, do të jetë imazhi kryesor i departamentit të lajmeve në "CNN", si dhe producente e lajmeve. Po ashtu, pjesë e "CNN" në

Shqipëri do jetë Anduena Llabani, me një përvojë pune për gati 2 dekada.

Ajo që bëri vërtet përshtypje këtë vit ishte rikthimi i pamenduar i një prej figurave më të mëdha të gazetarisë. Adi Krasta rikthehet në ekran dhe këtë radhë ka zgjedhur një nga ekranet më të mëdha informative në vend. Gazetari dhe prezantuesi i njohur televiziv sapo ka nënshkruar kontratën e bashkëpunimit me televizionin "News 24". Do të jenë pikërisht dy ditë ku do të shohim Krastën në ekranin e "News 24". E hëna dhe e marta do jenë dy ditët në të cilat gazetari do të jetë në "prime time". Emisioni do të ketë si logo të tij, inicialin "A" siç është parë edhe në ekranet e tjera që është shfaqur më parë. Por Krasta nuk do të mjaftohet me kaq! Dy projekte të tjera parashikohen të realizohen prej tij në muajt e parë të vitit 2019. Moderatorin e bashkëpunim me stafin e "News 24" ka nisur menjëherë nga puna për ndërtimin e studios së emisionit dhe brenda pak javësh pritet të dalë në transmetim. Surpriza të mëdha pritet të shfaqen në ekranin e "News 24".

Rikthehet fuqishëm

ADI KRASTA në "News 24"



//
E hëna dhe e marta do jenë dy ditët në të cilat gazetari do të jetë në "prime time". Emisioni do të ketë si logo të tij, inicialin "A" siç është parë edhe në ekranet e tjera që është shfaqur më parë
//



VALBONA SELIMLLARI, në një emision të saj

Ndërkaq, një rikthim me një emision krejt të sajën vjen edhe figura më e dashur për shqiptarët. Ikona e bukurisë, Valbona Selimllari rikthehet me emisionin e saj më të ri në ekranin e "Ora News". Bukuroshen e kemi parë në spektakle të ndryshme, madje për disa sezona ka drejtuar një emisionin "Nga e para" në "Vizion Plus", i cili kishte të bënte me ndërtimin dhe aredimitin e një ndërtese nga e para. Gjithsesi, ajo s'do të mungojë në këtë sezon të ri televiziv, veçse pjesë e jurisë së "Dance with me" në "Klan", ajo do të nisë një emision të sajën në "Ora News". Fokus i emisionit do të ketë sërish njerëzit në nevojë. Ende nuk dihet nëse emri do të jetë i njëjti. Presim surprizën e fundstatorit!

EVI REÇI, në "Top Chanel"

Jemi mësuar ta shohim gjithmonë në fushën e muzikës si një nga këngëtalet më të veçanta shqiptare. Por ajo që shumica prej jush nuk e dinte, është se Evi Reçi ka përfunduar studimet për gazetari në Itali dhe tashmë ka vendosur të rikthehet në vendlindje. Por cila ka qenë arsyeja e fortë e këtij rikthimi? Ka qenë pikërisht oferta e bërë nga "Top Chanel", e cila e ka sjellë këngëtalet në kryeqytet. Ende nuk dihet si do të jetë formati i emisionit që do të drejtojë, por nga eksperiencia e mëparshme mund të jetë i formatit të intervistave. Ende gjithçka pritet të shihet në fund të shtatorit.



Opinion i Ditës

Blofi fëmijëror i vetingut të politikanëve

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

...t'i propozojë Kuvendit edhe disa amendamente kushtetuese që deputetët t'i nënshtrohen të njëjtës "gjueti shtrigash", njësoj si prokurorët dhe gjykatësit.

Por, ideja e lëshuar papritmas, madje e mbështetur edhe nga kundërshtarë të fortë të tij, nuk është asgjë tjetër më shumë sesa një budallallëk me brirë.

Po t'i besosh sado pak propagandës që bën prej kohësh PD-ja, kjo nismë është thjesht utopike dhe e pa arritshme.

Si mund të pretendojë sot një opozitar, i cili këmbëngul se Edi Rama ka kapur tërësisht edhe institucionet e vetingut, që janë në monitorim të fortë ndërkombëtar, të besojë se kjo mazhorancë do të angazhohet kundër vetes së saj?

Si mund të imagjinojë ai, se amendamentet e reja kushtetuese që kërkojnë një shumicë të cilësuar do arrijnë të bëjnë bashkë me votat e demokratëve edhe ato të socialistëve?

Si mund të ëndërrojë ai, edhe nëse kjo ndodh falë ndonjë presioni hipotetik ndërkombëtar, që edhe pasi ta votojnë, socialistët nuk do ta minojnë këtë proces?

Pra, Lulëzim Basha duhet të ishte i ndërgjegjshëm se kjo as nuk ka gjasë të ndodhë dhe as mund të kryhet kurrë, për sa kohë Edi Rama është në pushtet.

Po atëherë pse e hedh idenë në treg? Thjesht për të gënjyer pub-



likun, apo se është një naiv i pashërueshëm që beson tek paktet me kundërshtarin?

Kësaj dileme mes Bashës mashtrues, apo të papjekur, dikush më dashamirës ndaj tij mund t'i shantonte edhe një të tretë: atë të njeriut që beson tek armët me të cilat politika luhet në Perëndim. Sipas këtij versioni, megjithëse ai është i ndërgjegjshëm se kjo sfidë nuk

realizohet, kreu i PD-së nuk këmbëngul kot në të. Ai kërkon ta shndërrojë këtë betejë në një vijë demarkacioni mes së mirës dhe së keqes. Ai e di që socialistët nuk e përballojnë dot këtë sfidë, prandaj e hedh atë në treg për të fituar besimin e publikut, për kredibilitet përpara njerëzve, në fund të fundit, për të treguar se kush është pro krimit dhe kush e lufton

atë. Po në pikën që kanë arritur gjërat në Shqipëri, pyetja që shtrohet është: edhe sikur të jetë kështu, a është efikase kjo rrugë? A mjafton fitorja e betejave të tilla për të ngadhënjyer në luftën finale?

Natyrisht që jo. Sepse Basha e ka provuar edhe vetë që kjo gjë nuk funksionon. Në çdo vend nor-

mal të globit, një pushtet që do ishte mundur edhe në betejën e dekriminalizimit (me mbi 20 të zgjedhur të nxjerrë nga politika), edhe në betejën e kanabizimit (ku kreu i rendit rezultoi i lidhur me trafikantët), do t'i kishte mbledhur valixhet me kohë.

Por në një arenë si Shqipëria, ku më tepër se votuesit luajnë rol paratë e oligarkëve, të fortit e dalë nga burgu dhe televizionet servise të qeverisë, të fitosh sfida të tilla politike është krejt e padobishme.

Pra në këtë kuptim, ideja e Bashës për vetingut e politikës është totalisht shterpë: e para, se është e perealizueshme dhe mbi të gjitha, sepse tashmë është eazuuar koha për të luftuar me mjete normale politike.

Kjo qeveri nuk mbahet më në këmbë, as se është e besueshme, as se ka simpatinë e njerëzve dhe as se ka mbështetjen e tyre. Ajo qëndron në zyra sepse ka kapur pushtetin financiar, mediatik dhe kriminal.

Prandaj me të nuk konkurrohet, as me gjetje ligjore, as me lëvizje shahisti dhe as ngrënie gurësh në damë. Me të janë të pafrytshme lojërat mbi tavolinë. Për të pasur shpresë të fitosh ndaj saj, duhet përmbysur treqe.

Sa më shpejt Lulëzim Basha ta kuptojë këtë, aq më parë do t'u japë fund propozimeve fëmijërore, si ato për vetingut e politikanëve. Sa më vonë që kjo të ndodhë, aq më shumë ai do vazhdojë të jetë fasada false e një regjimi.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion **i** Ditës

Trumpi s' mund ta neutralizojë lehtë Woodwardin

Nga Howard Kurtz

(vijon nga faqja 1)

... (sh. i përkthyesit: ish-vartëse e lartë e Trumpit, e cila ka botuar një libër shumë kritik ndaj tij).

Si një fitues i titujve "Pulitzer", që ka shkruar libra kritikë për çdo president qysh nga koha e Richard Nixonit, ai nuk mund të konsiderohet thjesht si një hanxhar i kategorisë së tretë, apo si dikush që ka një inat personal. Woodwardi ka qindra orë regjistrime të intervistave të tij me zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë, si dhe shumë dokumente që mbështesin librin e tij "Frika".

Por presidenti, sidomos, po mundohet ta sulmojë, duke i deklaruar portalit Daily Caller: "Është thjesht një tjetër libër i keq. Woodwardi ka pasur probleme kredibiliteti". Ndërsa një ditë më vonë, ai u tha reportereve: "Libri i Bobit s'ka asnjë pikë rëndësie, është thjesht i trilluar... Ai kishte të njëjtin problem me presidentët paraardhës".

Zyrtarë të lartë të administratës "Trump" nxituan t'i përgënjeshtrojnë komentet që u ishin atribuuar atyre në libër. Ndërsa Trumpi shkruajti në "Tweeter": "Libri i Woodwardit është diskredituar tashmë nga gjenerali James Mattis (Sekretari i Mbrojtjes) dhe gjenerali John Kelly (Shefi i Kabinetit). Citimet e tyre i kishte sajuar autori, një mashtrim ndaj publikut. Të ngjashme edhe citimet dhe historitë e tjera në libër. Woodwardi, një operativ i demokrateve? Rastësi koha kur po del libri?"

Më vjen keq z. President, por ta quash Bob Woodwardin një operativ të mundshëm të demokrateve, thjesht nuk ngjit. Ai botoi një libër të ashpër ndaj administratës "Klinton" dhe një tjetër shumë informues rreth keqmenaxhimit të konflikteve ushtarake nga administrata "Obama".

Në një tjetër mesazh në "Tweeter", ku shkruan "S'e di pse politikantët e Uashingtonit nuk e ndryshojnë ligjin për shpifjet", presidenti shfaq bezi ndaj mediave në përgjithësi. Sipas vendimit më të fundit të Gjykatës së Lartë, një figurë publike duhet të provojë se shkrimi i një gazetari është jo vetëm i pavërtetë, por edhe që ky i fundit e ka shkruar me keqdashje apo me një pakujdesi të pafalshme. Çfarë ndryshimi do t'i bëjë këtij vendimi Presidentit?

Woodwardi nuk është perfekt. Ka pasur gjithnjë kritikë rreth faktit se njerëzit që kanë bashkëpunuar me të për informacione i ka portretizuar më mirë në librat e tij, në krahasim me ata që



s'kanë bashkëpunuar (megjithëse ky është një problem me të gjithë gazetarët). Gjithashtu, disa nga episodet e raportuara në librat e tij janë mohuar nga njerëzit e përmendur në to.

Për shembull, John Kelly mohoi publikisht të ketë thënë se Presidenti ka dalë nga binarët apo se Shtëpia e Bardhë është bërë "një qytet i çmendur". Jim Mattis mohoi publikisht se e ka karakterizuar presidentin si një nxënës të kasës së pestë apo të gjashtë, duke e quajtur librin një trill. Ndërsa avokati Jawn Dowd mohoi që i ka thënë presidentit se mund të përfundojë me uniformë burgu, në goftë se pranor të merret në pyetje nga Prokurori Special, Bob Mueller. Këto janë mohime të forta.

Por, unë e kam parë nga afër Woodward-in kur punon dhe e di që ai nuk shpik gjëra nga hiçi. Njerëzit që i japin informacion mund ta keqinformojnë, mund të mos i mbajnë mend gjërat saktë, ose edhe mund të kenë axhendat/inatet e tyre personale. Por Bobi nuk trillon.

Kur mohoi ta ketë quajtur Prokurorin e Përgjithshëm, Jeff Sessions, "të vonuar mendërisht" apo "një jugor budalla", Trumpi tha se Woodwardi i sajoi këto fjalë për të futur përçarje.

Por të mos harrojmë se Trumpi ka shkruar pesë vjet më parë në "Tweeter": "Administrata Obama

nuk mund ta kalojë lumin duke sulmuar Bob Woodward-in".

Ndërsa gjatë bisedës së tij telefonike me Woodwardin në gusht (e regjistruar me lejen e Trumpit), Presidenti tha: "Unë do ta kisha dhënë më kënaqësi një intervistë të për librin. Ti e di që unë jam shumë i hapur. Mendoj se nuk më ke rënë asnjëherë kot në qafë". Por sapo pasazhet e para nga libri qarkulluan në media, qëndrimi i Trumpit ndryshoi.

Meqë ra fjala, dikja të ngjashme e përjetova edhe unë kur shkruajta librin "Çmenduria e mediave: Donald Trump, mediat dhe lufta për të vërtetën". Atëherë u kërkova disa zyrtarëve të lartë që të më rregullonin një intervistë me Presidentin, por asgjë nuk bënë. Dhe dy javë para se të shtypej libri në shtypshkronjë, mora një telefonatë, gjatë së cilës shprehu habi që nuk kisha pritur për intervistën me presidentin. Por edhe pas asaj telefonate, nuk u bë njeri i gjallë për intervistën.

Libri im, përveç armiqësisë së mediave ndaj Trumpit, pasqyroi edhe përpjekjet e ndihmësve më të afërt të tij për ta ndaluar të merrte vendime që ata i konsideronin të gabuara, apo të ndërmerre sulme personale. Këto përpjekje e përplasje të brendshme në Shtëpinë e Bardhë janë raportuar edhe në artikuj të pafundëm investigativë në media. Prandaj dhe nuk të çudit fakti që tema

kryesore e librit të Woodwardit është pikërisht "kriza nervore në pushtetin ekzekutiv", siç e quan ai.

Gjithashtu, vlen të theksohet se Woodwardi nuk bën pjesë tek kritikët publikë të Trumpit. Ndryshe nga ish-kolegu i tij i afërt, Carl Bernstein (i cili e ka quajtur presidentin e Trumpit keqdashëse dhe, pas librit të Woodwardit, edhe një emergjencë kombëtare), Woodwardi, dhe një emergjencë kombëtare, Woodwardi ka deklaruar herë pas here se mediat kanë qenë në disa raste të njëanshme kundër Presidentit. Ai ka qenë i ftuar rregullisht si në "Fox News", edhe në televizione të tjera.

Në vazhdim është një citim në libër i gjeneralit Kelly, që Woodwardi e përcjell në ligjëratë të drejtë, por që nuk është theksuar këto ditë në media: "Unë jam mburoja e vetme e presidentit ndaj sulmeve të mediave. Mediat duan ta shkatërrojnë atë. Ndërsa unë jam i vendosur t'i pengoj, duke i marrë mbi vete plumbat e shigjetat".

Me pak fjalë, libri na jep një tablo të shëmtuar të kaosit në Shtëpinë e Bardhë, por edhe roli antagonist i mediave është përfshirë në tablonë që na jep Woodwardi.

*Stacioni televiziv që pëlqehet më shumë nga Trump-i dhe përkrahësit e tij.

(Analist i televizionit "Fox News". Përkthyer nga Eduard Zaloshnja)

HOROSKOPI

DASHI

Po silleni me shumë kujdes në situata të shumta, po përpiqeni që t'i shikoni drejt aspektet e mira dhe të këqija në lidhjen tuaj dashurore. Është me rëndësi të harmonizoni mendjen me ndjenjat.

DEMI

Ndoshta herë pas herë po ju mungon durimi dhe përqendrimi për detyrimet në punë, të cilat kërkojnë angazhim më të madh. Do të keni një rol më aktiv në jetën publike, ndaj kushtojni kujdes takimeve që do t'u bëjnë këtë gjë të mundshme.

BINJAKET

Është e nevojshme që ta përsosni stilin tuaj të shprehjes, sepse ka raste kur kjo dhunti ka efektin e shumëfishit. Është me rëndësi t'i përfundoni të gjitha obligimet dhe mos lejoni që të tjerët t'i kundërshtojnë idetë tuaja financiare.

GAFORJA

Nuk keni nevojë t'i kujtoni vazhdimisht disa situata të parralizuara nga dashuria e kaluar. Dashuria merr forcën më të madhe vetëm nëse do të jeni mjaft të sigurtë dhe nëse do t'u besoni ndjenjave tuaja.

LUANI

Keni krijuar bindjen se personi i dashur me shkathtësi po përdor "mënyrën indirekte" që t'i realizojë qëllimet e veta, gjë që po shkakton edhe më shumë të ju pakënaqësi emocionale. Kërkon zgjidhje të reja në planin financiar.

VIRGJERESHA

Sekreti i suksesit tuaj gjendet në orientimin e saktë drejt qëllimeve praktike, për aftësitë tuaja, për vlerësim të mirë të situatave dhe për shkathtësinë e përshtatjes së shpejtë me kushtet e reja.

PESHORJA

Jeni duke ndier një presion të shtuar psikologjik dhe nevojën që të largoheni nga detyrimet e lodhshme. Ju presin rrethana të mira, të cilat ju garantojnë sukses financiar dhe mirënjohje publike.

AKREPI

Herë-herë po silleni sikur interesimi juaj emocional për një person të caktuar nuk është i karakterit afatgjatë. Nuk dëshironi ta ngarkoni veten me lidhje emocionale dhe po shpikni justifikime të shumëllojshme.

SHIGJETARI

Ndjeni një pasiguri emocionale apo nevojë që dikush t'ju bindë për qëllimet tuaja të mira. Po përpiqeni që t'i racionalizoni disa situata dhe nuk dëshironi që të ngatërroheni në telashet e vjetra.

BRICJAPI

Sapo të gjendeni një hap afër zgjidhjes, tek ju lind një dilemë e re emocionale. Është e qartë se situata sentimentale për momentin nuk është në formën më të mirë të mundshme.

UJORI

Ndjeni një shqetësim të brendshëm, por edhe nevojë të theksuar për dashurinë e dikujt. Po përpiqeni që aktivisht të merrni pjesë në ngjarje të ndryshme, por në këtë mënyrë vetëm sa do t'i shtoni dilemat tuaja emocionale.

PESHQIT

Ngjarjet e reja në skenën ekonomike po ju imponojnë që të ndërmerri veprime të shpejta. Megjithatë, strategjia të cilën do të zbatoni më në fund do t'ju sjellë rezultate pozitive.

Kuqezinjtë fitojnë të parën në Ligën e Kombeve. Bind Egzon Binaku

Khaka shënon, Strakosha mbron, Shqipëria mposht Izraelin

Mesfushori realizoi golin e fitores në të 55-ën

Jeton Selimi

Mrekullitë e Thomas Strakoshas dhe një gol për t'u vendosur në vitrinë të Taulant Xhakës, rikthyen Shqipërinë në rrugën e duhur dhe larguan hijet e shqarkimit për trajnerin Kristian Panuçi. Kuqezinjtë e nisën me këmbën e mbarë kompeticionin më të ri në rang përfaqësuesesh pasi mposhtën 1-0 Izraelin në "Elbasan Arena". Thomas Strakosha ishte heroi i padiskutueshëm i Shqipërisë në këtë sfidë me pritjet e tij shpëtimtare që ruajtën portën e kuqezinjve të paprekur por edhe Taulant Xhaka rezultoi deciziv me golin e tij. Rikthimi i gardës së vjetër i dha të drejtë Panuçit pasi aktivizimi i Bashës, Memushajt dhe Xhakës në mesfushë i ndryshoi fytyrën Shqipërisë që dinte të menaxhonte si duhet situatat kur kishte topin në këmbë. Në minutën 7-të Sindrit Guri iu afrua shumë golit të parë me fanellën kuqezi, por e ndali portieri i Izraelit. Në minutën e 30-të Strakosha tregoi të gjitha cilësitë e tij duke evituar një gol të sigurt pas gabimit të mbrojtësve kuqezi, me gardianin e Lacios që fillimisht ndali goditjen e Kajal nga shumë afër dhe në vazhdimin e aksionit bëri një tjetër pritje të shkëlqyer.



Në të 38-ën tentativa e Memushajt mori kundërpërgjigjen e portierit Haimov. Në të 41-ën një gabim i rëndë i Gjimshtit në kthimin e topit u duk sikur

i dhuroi golin e avantazhit miqve, por Strakosha bëri mrekullinë duke i hequr topin nga këmbët Eran Zahavit kur po i drejtohej vijës fatale. Me rezultatin 0-0 u mbyll pjesa e parë ndërkohë që pjesa e dytë nisi me një zëvendësim te

kuqezinjtë, me Balajn që mori vendin e Gurit. Minuta e 55-të vendosi dhe fatet e kësaj sfide, një kundërsulm i shpejtë i kuqezinjëve u shfrytëzua në maksimum nga djemtë e Panuçit, me Xhakën që gjeti goditjen fituese nga limitet e zonës

duke kaluar në avantazh kuqezinjtë. Pak çaste më vonë Balaj për pak sa nuk dyfishoi me kokë. Në të 62-ën një sprint i frikshëm i Xhakës i dha mundësinë Shqipërisë të shënonte edhe golin e dytë, por goditja e Hysajt pas pasimit të

mesfushorit të Baselit, për fare pak përfundoi jashtë. Në minutën e 75-të portieri i Izraelit i mohoi golin Hykës ndërsa në minutat e fundit Strakosha u bë sërisht protagonist me pritjet e tij, duke mbajtur portën të paprekur. Në Elbasan

Arena edhe pse nuk kishte shumë tifozë, ata që ishin të pranishëm u bënë krenarë me Shqipërinë që e nisi me fitoren grupin 1 të Ligës C në Ligën e Kombeve. Tashmë vëmendja shkon te sfida e të hënës ndaj Skocisë.



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Federata uli 50% çmimin e biletave para fillimit të ndeshjes

Vetëm 2 orë përpara nisjes së ndeshjes së parë në Ligën e Kombeve, që Shqipëria luajti përballë Izraelit në "Elbasan Arena", FSHF ka nxori një njoftim të ri për biletat që tronditi mjaft tifozët, sidomos ata që i kishin prerë më herët ato. Duke parë që ishin shitur pothuajse vetëm 4000 bileta në një ndeshje të Kombëtares, federata ka nxjerrë një ofertë për tifozët, ku biletat për në stadium shiten me 50% ulje, e thënë ndryshe, me të njëjtën sasi parash tashmë një tifoz mund të blinte dy bileta. Një rast unik ky që edhe njëherë nxjerr zbuluar FSHF-në dhe politikat e saj aspak mbështetëse ndaj tifozërisë.

TRAJNERI I SHQIPËRISË

Panuçi: Më kryqëzuat për miqësore. Fitorja vlen shumë para Skocisë

Trajnieri i Shqipërisë, Kristian Panuçi tha pas ndeshjes kundër Izraelit se ishte shumë i kënaqur me pjesën e dytë që bëri skuadra, por pjesa e parë ishte e gjitha për t'u harruar. Sipas mister Panuçit, skuadra ka ende shumë për t'u përmirësuar: "Eshhtë e vërtetë, rrezikua shumë në pjesën e parë, jo për meritë të kundërshtarit, por për gabimet tona. E përsëris, nuk u vumë në vështirësi për shkak të kundërshtarit, por për gabimet tona. Natyrisht, ju e keni bërë të madhe faktin që kemi humbur miqësore, me 10 lojtarë që nuk i kishim në dispozicion. Ato ishin dy miqësore testi dhe ju keni bërë gabim që na keni kritikuar. Kemi humbur dy miqësore dhe jo dy finale botërori. Shumë e rëndësishme ishte kjo fitore për transfertën e Glasgou kundër Skocisë. Kemi për të modifikuar disa probleme të vogla, të shmangim euforinë dhe të fokusohemi te Skocia. I përcjell komplemente lojtarëve dhe bënë një ndeshje shumë të mirë, sidomos në pjesën e dytë. E para kishte disa gabime, por reaguam dhe bëmë një pjesë të dytë shumë, shumë të mirë".




Sulmuesi i Izraelit, Zahavi: Meritonim më shumë nga kjo ndeshje

Sulmuesi kryesor i Izraelit, Zahavi foli pas humbjes kundër Shqipërisë, ku u shpreh shumë i zhgënjyer për rezultat. Sipas tij, Izraeli meritonte më shumë nga ky takim. "Ishte një ndeshje e vështirë, mendoj se bëmë një pjesë të parë më të mirë se Shqipëria. Shpresojmë që të marrin gjërat më të mira nga ky takim dhe të përmirësohemi për në ndeshjen e ardhshme. Kishim shumë shanse për të shënuar, por nuk ia dolëm. Shqipëria shënoi në një rast të vetëm të rrezikshëm dhe ne nuk morëm asnjë pikë. Më vjen keq që skuadra u ndëshkua kështu, pasi meritonim më shumë. Në minutat e fundit, gjithçka ishte e vështirë. E përsëris, dua që skuadra të marrë më të mirat nga kjo ndeshje dhe të bëjmë më të mirën në shtëpi kundër Shqipërisë dhe Skocisë".


MBROJTËSI

Hysaj: Rastin e humbur nuk do ta harroj lehtë

Elsaid Hysaj është shprehur i kënaqur për fitoren, dhe në një prononim për "Supersport" ka pranuar se rasti i humbur do t'i mbetet në memorie për shumë kohë. "Ishte e detyrueshme fitorja pas ndeshjeve të qershorit dhe më vjen keq që nuk fituam më shumë. Rasti që humba do të më mbetet në kokë për shumë kohë por duhet të shohim nga ndeshja tjetër. Nuk e di si e humba rastin, shpeshherë tregohem i saktë para porte, edhe pse dal pak. Më hutoi portieri, isha në dilemë për ta pasuar. Ai lëvizti majtas dhe vendosa të godas. E godita keq, pasi isha me dy mendje. Gjithsesi, rëndësi ka që fituam. Në Skoci shkojmë për të fituar, por një pikë na kënaq. Synojmë kreun e grupit dhe duhet të bëjmë gjithçka që t'ia dalim. Kritika? Nuk ndikojnë te unë pasi unë jam më të mirën për kombëtaren, por njerëzit që flasin atë punë kanë. Nuk kanë si s' shtynjë ndryshe kohën. Kemi dhe ndeshje tjetër shumë të fortë dhe duhet të harrojmë këtë ndeshje. Luajta lojën time dhe ishte skemë që nuk duhet të shkoja shumë para. Kam gabuar në pasime, por nuk kisha probleme fizike",-u shpreh Hysaj.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Me të nxjerrin një tapë.
- Initialiet e Klee piktor.
- Qiriaçi aktor.
- Eitkë pa kufij.
- Mërrën për shembull.
- Fund janari.
- Janë edhe ata të skuadrës.
- Ortolani kompozitor.
- Ushtrohej edhe nga bukanierët.
- Në krye të sondazheve.
- Janë të ndaluar në kthesë.
- Ente Rajonale Civile.
- Gjermania në tabela.
- Mund të jetë unik.
- Phillipe që qe aktor.
- Një pjesë e pelegrinazhit.
- Gjysmë leader.
- Maten pa zë.
- Janë të përpjeta.
- Qytet anglez.

- Louis, poet surrealist.
- Artet pa re.
- Matet pa kufij.
- Gruaja e Ben Hur.
- Liam i Schindler's list.
- Të parat në orkestër.
- Makina Ibiza.
- Renato, piktor i famshëm italian.
- Mihali këngëtare lirike.

VERTIKAL

- Mbyllin fushata.
- Një pjesë e pikturave.
- Janë njëvjeçarë.
- Një ngjyhet në tavolocë.
- Është katolik ai i papës.
- Mbyllin portat.
- Opera e Mascagni-t.
- Tregohet duke bërë masakra.
- Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- Një gjuajtës francez.
- Është porti i Durrësit.
- Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- Pak pirograf.
- Një pjesë e aerobisë.
- U vodhi zjarrin përndive.
- Premtojnë të bëhen asa.
- Mbeten në fund.
- Rreth pa ekstreme.
- Rendi pa zë.
- Është veshje tahitianësh.
- Tase e volejbolli.
- Është shahu i fundit.
- Kim... Stuart aktor.
- Fritz regjisor.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Një pjesë e ansambli.
- Ditngot teatral.
- Të parat në stacion.
- Qendër në tour.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Harris aktor.
- Termocentrali i shkurtër.
- Organizata me koska.
- Një tufë bagëtish.
- Initialiet e Redford.
- Kështu thonë se bëhet ai që mërziut.
- Scarlet e Bashkë e erën.
- Elvira aktore.
- Është Panorama që ke në dorë.
- Ushtojnë nga "ola".
- Shtet aziatik.
- Është ministri.
- Në radhtë të parë.
- G... për njerëzit e FBI.
- Makina Micra.
- Mund të jetë proteste.
- Pasur pa kufij.
- Gjika e Dora d'Istria.
- Të fundit në dhjetor.

VERTIKAL


- Umberto që shkroi Baudolino.
- Bertë këngëtare italiane.
- Fillojnë një temë.
- Një garë në hipodrom.
- Qe burri i parë.
- Një ndriçues.
- Bëjnë shirit me shi.
- I dha fillin Tezeut.
- Vihen për të mbyllur.
- Para Saint-Germain në futboll.
- Qëlton në një vend.
- Është dosja e të pandehurit.
- Janë përmasat.
- Mbush në kufij.
- I bëjnë duart me ar.
- Initialiet e dali piktor.
- Fillojnë argumentin.
- Makina Ibiza.
- Emri i Einstein.
- Ndriçojnë rrugët.
- Kim që qe aktore.
- I hedh i dorzuar.
- Initialiet e Nolte aktor.
- Ishin rapsodët e akejeve.
- Fund shkurt.
- Van der portier holandez.
- Fillojnë masat.
- Initialiet e Rohmer.
- Fillojnë teorikisht.
- Numerë i shkurtër.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		4		5	8		7	3
2		7						8
		6	2		7	5		
4	1			8	3			
	3		1		6		5	
		7	9				2	1
		5	3		1	4		
6					9		2	
8	7		9	4		1		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	4	1	3	5	8	2	9	6
9	2	8	4	1	6	3	7	5
3	5	6	9	7	2	8	4	1
5	6	4	1	2	9	7	8	3
2	3	9	7	8	5	6	1	4
1	8	7	6	3	4	9	5	2
8	1	3	2	4	7	5	6	9
4	9	5	8	6	3	1	2	7
6	7	2	5	9	1	4	3	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Dhe nganjëherë shkatërroni atë që doni, ndërsa përqijeni që ta mbrojnë...
- Nëse mendoni se aventura është e rrezikshme, provoni rutinën... është vdekjeprurëse
- Kur mund ta tregoni pa u rënkuar... Atëherë do ta keni tejkaluar atë ...
- Miqtë tuaj nuk dinë shumë gjëra, mirëpo dinë ç'të bëjnë po të jenë në vendin tuaj.

KRIPTOSKEME

3	P	2	U	6	S	I	15	2	3	5	7	3
2	4	8	4	7	8	6	9	1				
6	1		3	10	9	10	4	1	11	8	5	
12			3	8	11	7	4	8	13	8		5
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8		
10			3	8	5	8	5	1	11	8	5	
5	10	6	8		1	5	5	7	18			
1	8	4			3	4	8	11	1	13	10	
4	1	17	12	8	10	4		6	1	9		
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10	
4	2	16										
4	1	17	12	8	4	18				5	8	

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

B	P	K	E	T	A	H	A	M		
G	O	D	A	R	D	R	R	E	Z	E
O	R	E	G	O	N	S	T	N	I	T
L	P	A	L	L	A	T	E	T		A
I	R	O	N	Z	E	R	I	E	L	
A	Z	E	T	A	M	I	L	E	T	I
T	I	T	R	K	A	S	I	K		
H	S	T	A	R	A	T	T	E	K	E
I	H	A	D	A	B	M	O	N	E	T
I	R	I	N	I	S	S	I	T		
A	R	G	A	T	N	A	T	N	A	P
P	A	T	A	R	A	D	H	E	T	A

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

P A P A S S K U L V E
 A R A D M I N A T E G
 R A E D I S O N E B R O
 A R A T N T A S M A N
 F A T K O P E R T I N E
 I T M A T E R I A L E S
 N P A R A R E N D E S I T
 A A R T U R A I A V A
 C H I A R A T U L E T
 E O A I U S M J E T I
 C L I N T L U L I T E K
 K A P A G I T E T R O M E
 P E R V E N D I M E T
 A Z O V D A D I L E M A
 K O M E D I M I L A N E Z A
 P E R I O D I K E T E
 T I S A M A R I T A N E
 J K A M E R A M A N E V
 G A L E N I H T A S R
 U L A T B I B E R O N I
 L U I G T E R E N D E
 L A K E M A R A I S E T
 A R E N A N E M O T R E

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mënçura

- Harroni fyerjet, por kurrë mos harroni mirësinë.
- Në qoftë se ia thua ndonjë fshehtësi mikut tënd, mendo se edhe ai e ka mikun e vet.
- Nuk më intereson se çfarë mendojnë të tjerët... për atë që unë bëj, por më intereson shumë se çfarë unë mendoj në lidhje me atë që bëj.
- Ky është karakteri!



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM GILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tirane, Cel. 065 20 16 816, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



- Na mermi!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

- Facebook: Gazeta Shqiptare
- Instagram: gazetashqiptare.al
- Twitter: Gazeta Shqiptare
- E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
- Youtube: Gazeta Shqiptare

